BLERIM SINANI

Dielli, Hëna dhe Bora

/roman /

Editor
Azam Dauti

BLERIM SINANI

Dielli, Hëna dhe Bora

/roman/

Shkupi
Shkup, 2OO9

Kushtuar me mall,
fëmijëve të mi:
Unikut
dhe **A**rbesës

DIELLI

Një ditë e rëndomtë si çdoherë kur bën vapë. Njerëz të molisur, të djersitur, që kundërmojnë gjatë kur kalojnë përreth nesh. Dielli në horizont lart, duket i paprekur, por edhe i padukshëm; e shohim se shohim. Unë dhe Niku, vendosim shuplakat e vogla në fytyrë, e mes gishtave mundohemi që ta shohim topin e kuq në të bardhë dhe plotë zjarr.
Këtu në Arak, nuk ke edhe ç'të bësh diç më shumë, ose të vraposh me qëllim ose të afrohesh drejt plepave të gjatë që shihen diku në largësi nga rruga jonë. Unë dhe Niku 5-vjeçar, gati të një moshe edhe pse pranoj se unë mundem të jem pak më i madh kemi një gjuhë të përbashkët dhe mirë ia kalojmë. Mamaja ime të cilën e quajnë zonja Ruka, dhe mamaja e Nikut zonja Haam, çdoherë janë në parkun e shtëpisë sime dhe çdoherë diçka llomotisin. Ne nuk i kuptojmë fare dhe ashtu në bisedat e tyre, ne fshehurazi ikim e dalim në rrugë. Në vapë në Diell, ashtu na pëlqen. Mua më ka ëndja ta shikoj edhe kodrinën pa lisa mbi Arak, e cila i përngjanë një krahu të madh të një ariu.

Ku shkuan, këta kalamaj lazdrak, a mos u humbën? Shih, Haam mos janë tek bunari i vjetër? – Ah, këta fëmijë sa të lazdruar që janë. Nuk dëgjojnë fjalët e prindërve – s'kanë respekt. Nikuuu! Blertiii! – hej, Bleri; këto zëra na u janë bërë si gjilpërat e tetës Nexh. E din, Blerti, kur isha para ca jave në ambulancë për të më vaksinuar? E kam sharë dhe ia kam marrë një laps tetës Nexhë. Më pickoi me gjilpërë në krah – fillova të qaj. Por më kujtohet atë lapsin se teta Nexhë ma dhuroi e unë fillova të buzëqeshi dhe ti kërkoj falje për sjelljen time.

Nikuu, Blertiii! – Po, ja ku qenkeni mor djallusha dallëndyshe, sokola... (tani do të thonë – trima, bukurosha). Çdo ditë të njëjtat fjali. Po ne (unë) mami ishim te porta e oborrit me Blertin, e jo portë ja ku është. Ajo nuk është në Hënë! Është pak larg, por është edhe shumë afër. Hëna! Hmmm.

Ç'më lindi kjo fjali në kokën time të vogël, (ashtu mendoj se kur shihemi në hije në këtë ditë me Diell, më duket koka si një top vërtetë i vogël), përmendi Hënën.

Hej Niku; fol be Blerti! A mu dok, apo të dëgjova kur bisedoje me mamanë tënde diçka për Hënën? Eh, lere më atë.

Mjaft e kemi këtë Diell mbi kokat tona të vogla. Hi-hi-hi, por qe besa Blerti, edhe ti e ke kokën e vogël. Mos ke gajle, kur të

rritemi do t'i kemi sa topi i xha Emras, që luan te shtëpia e xha Mitit (Hi-hi-hi).
Hëm, Hëna! E din se ç'ka është Hëna? – jo, por t'i Blerti je pak më i madh se unë dhe ti e din se ç'është. Unë si Nik i vogël e di vetëm që atje ka xhuxha. Ata janë njerëz të mëdhenj, por të vegjël sa ne. Ata kanë mjekra të bardha, dhe secili ka nga një violinë të vogël. Po, a? E tjetër, tjetër. Niko ç'ka në Hënë. Kështu, e di edhe se atje është babi im, larg i cili çdoherë kur bie borë, ai me aeroplanë fluturon dhe më shikon prej lartë dhe prapë kthehet diku që as unë nuk e di se ku. Aha? – po qenka mirë more Niko atje lartë! Po! mirë është në Hënë, e bukur është ajo, por Dielli është më i mirë. Po, Blerti, Dielli është më i mirë se Hëna, se ai e shkrinë borën. Jo, Niko, Hëna qenka më e mirë se Dielli. Të them ty Blerti, se ai është më i nxehtë dhe më i mirë.
Dëgjo, Nik! Hëna bën dritë si Dielli, dhe është e mirë. Blerti, Dielli është... Nik të them se Hëna, jo Dielli, jo Hëna, Dielli, Hëna...!
Off, kujdes! Blerti t'i më shtyre! Pse jam më i vogël, a? Po ti Niko nuk më dëgjon mua. Unë të kuptova se në Hënë, atje diku larg është babai yt, dhe nganjëherë tha se prej lartë të shikon, dhe ti mezi pret që të vijë tek ti. A, ishte ashtu Niko, fol!

Po, sa i marrë që je more Blerti. Unë a të thash se Dielli është më i mirë, sepse ai e shkrinë borën. Asnjëherë kur ka Diell nuk ka borë. Babai im kurrë më s'ka për tu larguar nga unë, sepse çdoherë kur bie borë, ai më lë të vetëm. Hëm. – Aha, po shih, unë tani të kuptova. E kam tërë të qartë. Më fal të lutem; ma jep dorën. Ti Niko je shoku më i mirë që kam. Edhe te Blerti je shoku më i mirë i imi. Kalojnë njerëz për rreth nesh, dhe për çudi as që na vërejnë. Ne i shohim dhe qeshim me ta kur ua vështrojmë ato koka të rrumbullakëta si kungujt e xha Nelit – fqiut. (Hi-hi-hi).

Zonja Haam, si duket është bezdisur nga llafosja disa orëve dhe e njëjtë, përshëndetet me zonjën Ruk dhe e thërret Nikun.

Eja, duhet të të pastroj; shih se ç'farë ndyrësire je bërë! I tërë je pis nga pluhuri i rrugës dhe asnjë fjalë timen nuk e dëgjon, - murmuritën zonja Haam. Ashtu qenka, Haam; shihe këtë Blertin tim të djersitur nga kjo vapë. Vërtet qenka bërë kloun.

Nikooo, të përshëndes, shihemi të nesërmen. Po, të nesërmen Blerti!

Po, si mor Nik nuk dëgjon? A, të kam thënë, se e sa herë që në rrugë, në pluhur, në Diell mos të luash? Sa e sa herë të kam thënë që të mos largohesh nga shikimi im, blla, blla, blla... (A thua Blertin do të

qortojë zonja Ruk që është djersitur nga vapa – Dielli?) – Më fal mami të lutem më fal; (më mbushën sytë me lot, më dridhet zëri...). Mirë, de mirë, unë të kam zog, pëllumb, dallëndysh, mos qaj tani, je ende i vogël, po gabon nga pak, por nuk është bërë deti kos.
Mirë mami, nuk do të gaboj më kurrë, por të të pyes diçka?
Fol Niko! – Mami, mami, ti e donë Diellin? Po si jo be djali im. Po ti mami e donë Hënën? Hëm, po si jo be djali im. Po, ti mami kë e do më shumë: Diellin apo Hënën? Po të dyja i dua o dalldish i mamit. Eh, ç'farë pyetje tani këto? Po ti kë e do më shumë, o mami kënd, kënd; Diellin apo Hënën, më trego të lutem mami, sepse unë e dua më shumë Diellin. Ai e shkrinë borën dhe nuk e lë që ajo të bie në tokë, e nëse nuk ka borë, as babi nuk shikon atje larg, ndoshta te hëna, a?
- Oh djali i mamit, ty të kam një dhe të dua më së shumti në botë, por lëri këto mendime tani e shih se ç'bën motra jote – Besa. Pyeta, a i ka bërë detyrat? a ka fituar shpejtësi në të lexuarit? Shko, tani në dhomën e juaj por Besës mos i pengo. Radhiti katrorët e vegjël si mbrëmë dhe ndërto rrugë, ura, luaj por mos i pengo, a? E, unë do të bëj një puding që dyve ua ka endja shumë. OK?
Mirë mami.

- Lisi plak i hutuar nga vetmia është harruar nga të gjithë...
Besa, Besa... fol Niko! Fol por më shpejtë se duhet të mbaroj dhe të fitoj shpejtësi në të lexuarit e tekstit, e që e kam detyrë shtëpie. Fol de tani ç'pret?
Eh, gjeti, gjeti një mi vogël. Tani e humba rreshtin se ku isha. Si do të dal unë në klasë të dytë, me ty në dhomë, e me këto sjellje a?
Pëshsh, mëshsh, rëshsh... (pëshpëritë Niku me zë të ulët diç), do ta marrë një katror edhe një katror dhe një katror tjetër një të madh, a do të ndërtoj një rrugë edhe një shtëpi, por një shtëpi të madhe të madhe sa ai krahu i madh i ariut që shtrihet mbi Arakun tonë. Atje do t'i dërgoj shkallët e drurit që janë pos shtëpisë. Do ti them edhe Blertit që të më ndihmon pak, e di, ai do të më dëgjon. E kam shok të mirë, bile do të ti them që shkallët ti dërgojmë lartë mbi atë kraharor të madh kodrine.
Mbarova! Qjë, duke lozur Niko? Oj Besa! të të pyes diçka? Ti më shumë e do Diellin apo Hënën? Aha! Unë vëllaçko im i vogël më shumë e dua Diellin.
Urraa, edhe unë më shumë e dua Diellin. Të kam motër, motrën më të mirë në botë.
Niko, unë mbarova me detyrat e shtëpisë, tani të shohim se ç'bën mami. Mami, ku je? Ja në kuzhinë jam. Ç'keni? Mos jeni kacafytur prapë si mbrëmë për ato shkallët

e Nikut të ndërtuara me katrorë? Jo, jo, deshëm vetëm që ta ndjejmë atë zë tëndin të ëmbël mami i jonë e dashur. Aha, - po ja de ku jam, dhe jam duke u përgatitur ëmbëlsirë – puding luleshtrydhe! Puding luleshtrydhe? Besa e do pudingun prej luleshtrydheve, por unë më shumë e dua prej çokollate.
Mirë de Niko! Dje patëm prej çokollate, sonte do të kemi prej luleshtrydhe – për Besën.
Mirë, mirë, ashtu pra qenka puna, mua askush nuk më donë. Vetëm Blertin e kam shok.
Ha-ha-ha, por edhe ty be Niko do të bëjmë pak puding prej çokollate. A bën? Urraaa (u gëzua guri pa masë).
- Mami, nesër në shkollë dua që të vish atë fustanin me arinj të vegjël dhe luleshtrydhe mali. Shoqet më janë mahnitur, dhe më kanë pyetur se ku e kam blerë.
- Dhe ti si u the? Po unë mami u thashë se këtë fustan e kam dhuratë nga halleja Lid për ditëlindjen time. Po, ashtu është, edhe nëse ju pyet dikush diç duhet çdoherë ta thoni të vërtetën. E vërteta, fëmijë të mi të dashur ndoshta ndonjëherë mundet të ju lëndon, por e vërteta në fund çdoherë fiton. A, më kuptuat? (Besa) – Po mami!

(Niku) – Po po, mami! (Edhe pse s'kuptova asgjë, se ç'deshi të thotë mami për të vërtetën).
(Ding-dong-ding-dong... ora 21.00). Nik, eja cili më shpejt arrin te dhoma për t'i marrë pixhamat dhe cili më i pari do bëhet gati për gjumë. (Tras, bum, plass eee) Ti je më e madhe, e unë jam më i vogël, ti çdoherë e para arrin te dhoma.
- Gati? – Gati, mami! Natën e mirë, gjumin e ëmbël si përsheshi me tambël.
(në mëngjes) Një rreze Dielli në mëngjes më xigilonte njërën qepallë dhe sikur më thoshte që ta hapi njërin sy.
Vetëm njërin sy a! E kur të sheh ai syri i vogël se ç'ditë e këndshme është sot, edhe syri tjetër vetë do të hapet, dhe me të vërtetë ashtu ishte. Besa flinte ende mami ishte në kuzhinë e unë ika në banjo. Aty e kam një ulëse të vogël e keqe dhe e ftohtë, ku për çdo mëngjes mami më ka thënë se duhet të ulem aty. Por s'ka gajle. Kur të rritemi i madh mundem të ulem te ajo ulësja e madhe.
Mirëmëngjesi, mami.
Mirëmëngjesi dallëndyshe im! Po si ke fjetur, ke parë ndonjë ëndërr? Ke fluturuar si pëllumb?
Jo, mami asnjërën prej këtyre që i përmende nuk i kam parë përveç Diellin.
Diellin? Ëndërr e ka pa Diellin? Jo, mor Niko im i vogël. Diellin e ka parë në

mëngjes, me ato rrezet e tij të arta, që ngadalë t'i kanë hapur qepallat e gjata, dhe ata sy të njomë, por ku ta di ndoshta vërtet e ke parë, a?
Ti mua nuk më gënjen. Si jemi marrë vesh. Çdoherë duhet thënë të vërtetën, a?
Unë po të them se e kam ëndërruar Diellin. Diellin e kam parë ëndërr, vetëm Diellin. Mirë de mirë e ke parë e ke parë, asgjë të keqe nuk ka këtu. Ja edhe sot tërë ditën do ta shohim të gjithë.
- Mami, ti e do Diellin?
-Po si jo mor shpirti im. Shumë e dua Diellin. Urraaa.
Do të dal, e ta thërras Blertin, e ti them se edhe mami im, edhe Besa, edhe unë të gjithë e duam Diellin.
Mirë, mirë, ngadalë. – Blerti ndoshta ende flenë e ti nuk ke ngrënë asgjë. Të pishë një gotë qumësht dhe të hashë në gurabije e mandej luajmë. OK? Mirë, mirë mami! Ok! (Gjam, gjam, sircc, njamm njamm).
-Niko, o Niki!
-Mami, mami, më thërret Blerti. Mundemi para portës së oborrit të luajmë? Brenda në oborr të luani, në gjelbërim, nën hije, ashtu po u them unë, e jo në rrugë, në Diell. Po mu për këtë mami, para portës është Dielli e jo nën hije…
Si je Blerti? Opaa, paske një fanellë të re. Kush ta bleu? Mami apo babi yt? Babi im ma ka blerë në qytet. Së bashku një ditë

me atë veturën tonë të vjetër shkuam në qytet dhe shëtisnim nëpër dyqane, e pashë këtë fanellë dhe bërtita: E dua këtë, e dua këtë.
Mami, besa pak më shikoi me sy të trembur, por falënderoj babin që menjëherë u pajtua dhe ja ku e kam sot. Por, edhe ti Niko paske patika të bukura, pak të vjetra më dokën, por të mira qenkan. Po, a mos janë ato patika që i kishe kur shkuam të shohim futboll se si luajnë xha Emra dhe të tjerët? Por ajo ishte moti kohë a? Më doket se kemi qenë edhe më të vegjël. Si milingona (hi-hi-hi), ashtu të imtë. Po de, Blerti këto janë ato patika që mi pate shkelur, e që më the se për çdo send të ri ashtu është adeti. Kam edhe disa palë tjera, super të reja, por këto i dua më shumë.
-Këto mi ka blerë babai im, por ç'bëjmë sot ne?
Ke ndonjë ide? Luajmë, luajmë; ç'doni ti Niki të luajmë sot? Hej, Blerti! Ti je më i madh. Të të pyes diç. – Urdhëro!
-E kam dëgjuar por s'mundem ta qëlloj fjalën për ata njerëz që kanë rrobe të bardha dhe kapela në formë të topit e që shkojnë – ngjiten lartë në Hënë? Kozmonautët po mendon. Niki? Po, de ata ozonatët (hi-hi-hi), ti je aq i vogël sa që në të vërtetë nuk mundesh ta thuash emrin e kozmonautëve (ha-ha-ha).

Mirë pra. Po si mendon të luajmë kozmonautë, dhe pse duhet të shkojmë në Hënë?
Hej Blerti dëgjomë. Të tregoj diç. Kam ndërtuar rrugë, e ura nga katrorët e mi mbrëmë në dhomën time të vogël, por edhe shkallët e drurit që janë të rënda e të gjata i kemi pas shtëpisë sime. Po, dhe?
Ngadalë do ti marrim e do të ngjitemi lart mbi kodrinën e Arakut dhe pasi të afrohemi afër Hënës, i marrim shkallët dhe ngjitemi lart.
(Hi-hi-hi). Po, Niko kjo nuk është e mundur, si do të ngjitemi lart te Hëna? Dëgjo tani, të them unë ty diç tjetër…
-Zonja Haam, oj Haam, a je aty? Niki, kush është? Mami, mami unë me Blertin jemi tek porta e oborrit e ty të thërret zonja Ruke. Po, a?
Ja tani, erdha. Urdhëro Ruk. Si je? I bëre punët?
Eja të pimë nga një kafe. Jo, jo Haam. Kam bërë çaj me kullaqe dhe nëse je gati eta. Të pres.
Askënd nuk e kam në shtëpi, veç Blertin i cili ja ku lozka me Nikun tënd, e mua më kaploi një monotoni. Eja e bisedojmë e qajmë halle.
-Mirë Ruuk do të bijë. (Tak, tuk-tak-tuk).
-Niki: unë jam këtu menjëherë, tek teta Ruke, a?

Hëna

- Pra Blerti, ti kishe një ide. Ç'farë doje të thuash. Shih Niki. Ne do t'i mbyllim sytë dhe do të mendojmë se jemi në një avion të vogël që do të na shpie në Hënë.
- Eh, e si mundemi ne të vozisim, aq të vegjël, dhe ku do ta gjejmë një të tillë?
- Niko, unë i mbylla sytë. E, ti? Ja, ja de dhe unë i mbylla sytë dhe çka tani! Hej Bleri po e ndjej një dridhje tek këmbët e mia dhe diçka po bubullon. Aha, edhe unë po e ndjej një gjë të tillë – një dridhje të tokës.
Ti hapim sytë, e të shohim ç'po ndodh!
Po si? Ç'ndodh? Ku jemi?
Kush janë këta? Ç'janë këta? Ç'është kjo more Niko?
Blerti, unë kam frikë.
Ndal Niko, se më duket se nuk na hetuan. Por, aq e madhe e ndritur qenka kjo?!
Më duket se ky gjësend fluturon. Të ecim ngadalë e të shkojmë nën atë shkollë të bardhë, paska një dritare nën to. Oboboo! Po ne si arritëm në maje të kodrinës së Arakut bile ai kraharori i madh i ariut zvogëloheshka ngadalë. Shihe, Niko, edhe shtëpitë tona nuk po shohim më, u

zhdukën. Ç'farë errësire jashtë. Yje pa kufi. Të bardhë të kuq, të verdhë. Oboboo!
Mirë, të qetësohemi pak Niki. Po, Blerti, ne qenkemi në atë avion që ti e përmende, por ky qenka shumë më i madh dhe paska njerëz edhe atë të vegjël qenkan. Këta janë xhuxhet, që njëherë i pate përfolur more Niko.
- Dhe të them Ruko, se diçka me Nikun është duke ndodhur. Tërë kohën më pyet se kë e donë më shumë, Diellin apo Hënën. Ç't'i them; Më erdhi t'i them se e dua Diellin. U gëzua pa masë bile sa nuk filloi të qajë prej gëzimit.
- Mendova, se gjatë ditës do të dëfrehet më shumë duke e shikuar Hënën, por ç't'u bësh – fëmija si fëmi, imagjinata të pafund. Po, ti Haam, si je? Të lajmërohet Rini? Ç'thotë, kur do të vjen? Me shëndet si është? Eh, moj Ruuk, e vërtetë është se ti je shoqja ime më e afërt – mike me vend. Mërzia ime është e pashtershme, por shkaku i fëmijëve qëndroj krenare dhe e paluhatur, sepse ti e din, se fëmijët gjithçka përcjellin e mbajnë mend.
Rini më ka thënë se diku në pranverë do të jetë këtu, gjë që nuk ka mbetur më shumë se gjysmë viti.
Ai, pati që të vjen këtë pranverë, por ja kapi vera dhe e zuri gati vjeshta, e besa një kohë bukur e gjatë kaloi por ç'të bëj ne shqiptarët jemi mësuar që me shekuj të

vuajmë. Të jemi të mërzitur çdoherë, o për këtë, o për atë, asnjëherë të gëzuar dhe të lumtur. Falë zotit. Besa, vajza ime më ka ngjarë mua nga karakteri, ashtu e vendosur. Ja pak më parë e përcolla për në shkollë, mirë është, e Nikun e lashë me Blertin tënd duke lozur afër portës së oborrit.
Po, ty Ruuk, si të shkojnë punët? E ke Merin këtu, dhe si dukët ende është agjil. (hi-hi-hi).
Po si të gjithë meshkujt de, po e din ti më. Një puthje e tyre dhe gruaja shndërrohet në laborator kimik.
Fakt se dashuria është ende e zjarrtë me Merin dhe nganjëherë mjafton vetëm shikimi i tij aq sa i vrazhdët aq edhe i butë.
- Shihe, shihe, këta nga erdhën? E kush jeni ju o kalamaj të vegjël?
Unnee jaam Blertii, e ky është Nikku. Jemi nga ajo shtëpia poshtë që u zvogëlua dhe tani kemi humbur, nuk e dimë se ku jemi. Hëm. Zed!
Urdhëro i larti Lunar. Merri këto fëmijë, dërgoi në dhomën time dhe mbylli brenda. Si urdhëroni i larti Lunar.
- Fëmijë, ejani shpejt me mua!
- Uauu, sa drita të bukura. Më dukën si në Lluna park. Hesht tani Niki, e sheh se nuk janë mikpritës? E pe atë shikimin e atij mjekërgjatit të bardhë si dëbora se si ishte?

Blerti, po ku po na shpien? Hesht tani!
- Futuni brenda! Mos lëvizni! Pas pak qaste do të kthehet i larti Lunar. Trasss.
- Shiko, Blerti! Po kjo nuk qenka edhe aq dhomë e keqe. Paska katrorë ashtu sikur i kam edhe unë. Shih, shih një biçikletë, jo edhe një kukull.
Niki! E shikon atë violinën e drurit me ngjyrë ari? Po e shoh dhe? Po këta njerëz të vegjël me mjekra të bardha si dëbora qenkan xhuxhët e Hënës. Ne si duket po shkojmë në Hënë. Në Hënë? Urraa! Pssst! Mos bërtit! Po të na dëgjojnë, dhe mundem që ta na hedhin jashtë.
-E duaa mamin këtuu! Dua që të shkoj te mami. Niki, të lutem hesht tani dhe të shohim ai mjekërgjati se ç'do të na thotë.
- A këtu qenkeni a? Po si erdhët bre ju këtu? Ende nuk e kam të qartë se si ia arritët që të jeni këtu! Ndoshta me një dëshirë të zjarrtë për diçka që secilit fëmijë një herë në jetë i realizohet e kërkon dhe bëhet. Por, jo jo, ju nuk mundeni të keni këso dëshirash që të ndodhë kjo. A po jo? – Ashtu është zotësi mjekërgjatë, mjekërbardhë.
Lunar e kam emrin. Ju mundeni të më thirrni xhaxhi Lunar. Unë nuk kam asnjë dëshirë veç se të kthehem tek mami im. Por kjo nuk na e mundësoi që ne të jemi këtu për shkak të një dëshire.

Edhe Niku nuk ka këso dëshirash që do ta kishin prurë këtu. Ngadalë Blerti mos u ngut! Xhaxhi Lunar, ç'do të thotë emri juaj? Hmmm.
-Unë jam prijës i njerëzve të vegjël gjë që ju i quani xhuxhë të Hënës. Po në atë yll, të madh të kaltër e të bardhë nga pak, që natën e ka formën e topit, e fëmijëve që kanë humbur rrugën u bënë dritë. Aha, domethënë ju paskeni qenë në Hënë. (Ha-ha-ha) – O vogëlushi im: Unë shtëpinë e kam në hënë. Ne në Hënë banojmë. Këtu jetojmë. Më fal xhaxhi i Hënës – xhaxhi Lunar, por unë dua të shkoj të mami im. Niki, qetësohu, se do të shkojmë tek shtëpitë tona...
- Dhe si të thashë Haamë, ashtu e ka jeta. Mirë bre Ruko, të tregoj diçka. Ky Niku im i vogël disi më duket se ka ndryshuar. Po mendoj në sjellje disi më është pak, si i çuditshëm, aq sa që mbrëmë më pyet se kënd e donë më shumë. Diellin apo Hënën. Dhe ç'ka moj Haam ka këtu për tu habitur? Jo, jo asgjë veç se unë thjesht iu përgjigja se e dua Diellin, e sa më dëgjoi. Niku im ngriti duart lart, u gëzua pa masë, dhe më tha se edhe ai, e deshka më shumë Diellin. Ç'ka ndodhi mandej? Asgjë, prapë deri kur vetvetiu më thotë se Diellin e dashka më shumë, sepse Dielli po e shkrika borën. Eh, moj Haam, e tani asgjë

s'po kuptoj. Ç'ka lidhje Dielli me borën? Ndal pak prit.
-Rini, burri im, babai i Nikut çdoherë paska shkuar në kurbet atëherë kur paska rënë borë. Po, mos të kishte rënë borë. Rini s'paska pas për tu larguar Dielli nuk e lejon borën që të bije, e shkrirë menjëherë.
-Mu mbushën sytë me lot, më shtrëngoi gjoksi, mu dridhën buzët dhe e përqafova Nikun, i cili nuk e kuptoi se ç'ngjau në ato momente me mua, por një nuk e kam prapë të qartë se kush i tregoi dhe si ju kujtua një gjë e tillë... Ehhh...
-Zotëri, njeri i Hënës! A, të gjithë njerëzit në Hënë, janë sikur ju, ashtu të mëdhenj, por të vegjël me mjekra të bardha, apo ka edhe njerëz të mëdhenj, pa mjekra të bardha ashtu të bukur, sikur babi im, me flokë të zeza, dhe buzëqeshje të ëmbël.
Ndal, Niki, se këtu veç këtu veç këtyre xhuxhëve, njeri tjetër nuk paska. Jo, ndal pak, prit, si e pate emrin ti çuni? Blerti! Ky çuni i vogël emrin emrin?! Niki, xhaxha Lunar. Ky Niki i vogël disi e ka të drejtë.
Herë pas herë në Hënë me vetura që fluturojnë vijnë njerëz të mëdhenj si ne, më të lartë se ne, pa mjekra, të bukur, me flokë të zeza, për ti shikuar fëmijtë e tyre në shtëpitë e vogla, por menjëherë kthehen, dhe ashtu vazhdojnë.
Po, a? Të lutem xhaxha i Hënës kur do të arrijmë tek shtëpia e juaj? Ndal Niko? Mos

shpejto? Në duhet të kthehemi në shtëpitë tona në Arak. Tek mamatë tona e jo të rrimë në Hënë.
-Jo, Blerti, jo! Dua të shkojmë sa më shpejtë në pjesën tënde të Hënës – në Hënë. Ndoshta e takoj babin tim të dashur. Pak ia kam harruar fytyrën por atë buzëqeshje të ëmbël dhe ato duar aq të forta, dhe aq të buta nuk i ka askush, dhe shih xhaxhi i Hënës, i larti Lunar, domethënë, flokë të zeza, vetulla të holla... mirë de mirë të kuptova.
Ja tani më duket se jemi duke u afruar afër shtëpive hënore dhe do të pimë nga një limonadë të larme. Limonadë të larme? Uauu... Shshsh.... Trass. Erdhëm.
Ngadalë çuna. Këtu fëmijët fluturojnë, ne mundemi të kërcejmë lart.
- Ç'farë mrekullie qenka Blerti këtu, a?
Po, po Niki, por të shohim, a? Dhe ç'është ajo Hënë e kaltër tani atje lartë, o xhaxhi Lunar?
(Ha-ha-ha). Ajo nuk është Hënë. Ajo që po e shihni si një top vërtetë i kaltër është shtëpia e madhe e vëllezërve e motrave tuaja. Atje janë shtëpitë e juaja.
Po, çuna të dashur, ajo atje që po shndritë është shtëpia e juaj e vërtetë.
Blerti më kap për dore e të fluturojmë pak, a? Urraaa! (hi-hi-hi) po sa bukur qenka. Mrekulli.

Kërcen lartë dhe kur bir nuk lëndohesh. Por të shohim ne se ç'gjësende tjera paska këtu, a Blerti?
Mirë, Niki të ecim – kërcejmë ngadalë.
Shih një lule – sheqerkë që i ndërroheshkan ngjyrat.
Shih shih një shpend me bisht të gjatë dhe me këpucë xixa xixa. Më duket se e shoh Ylberin me ngjyra shumë.
Prit pak. Ndal, ndal, uleni kokën shpejt Blerti. Niki, këta janë bletat e arta të Hënës, që janë duke u kthyer prej ujëvarës, ku uji është i kaltër dhe i rrethuar me gurë të kristaltë të ëmbël. Uau. Jemi të mahnitur xhaxhi i Hënës, por të shkojmë në shtëpinë tuaj e të hamë diç.
Jam i uritur tej mase, nuk e di për Nikun por unë jam i uritur.
U bë çuna të mirë, shkojmë në shtëpinë time.
(Xiv-xav-Xiv-xav, ksa, kse, ksi)... erdhe babi? Kërcyen dy fëmijë shumë të vegjël, edhe më të vegjël se ne, dhe e përqafuan xhaxhin e Hënës, gjegjësisht kuptuam se ai ishte në të vërtetë prindi i tyre e këta kalamaj ishin fëmijët e tij.
Një çun dhe një çupës. Disi ishin më ndryshe se ne, por në sjellje mu ashtu sikur të gjithë fëmijët njësoj?
-Lunar! Bërtiti një grua e cila nuk kishte mjekër, por buzë të kuqe dhe sy të kaltër. Ishte mamaja e kalamajve hënor. Të gjithë

u gëzuam ashtu thjeshtë shtëpinë e kaploi një nxehtësi familjare.
Unë, pak u tërhoqa, dhe dy pika loti më pikuan.
U habita se sa shpejtë më rrodhën nëpër faqet e mia të njoma.
Niki! – Urdhëro xhaxhi i Hënës. Ty do të japim një limonadë të larme, dhe mjaltë të mbledhur.
E, ty Blerti do të japim sheqerka që në dhëmbë kërcëllojnë dhe nuk mund t'i zësh. (ha-ha-ha).
- Zonja e Hënës, me kalamajtë e saj na shikonte ashtu po ndërprerë dhe diçka pëshpëriti me xhaxhin e Hënës. Menjëherë nga sytë e saj të kaltër, rrodhi një pikë loti, e cila u shndërrua në kristal të kuq, mu ashtu sikur mami që e ka në një unazë të gishtit.
- Pasi u ngopëm me Blertin filluam që të shëtisim nëpër dhomën e kalamajve të Hënës, që na tregonin gjithçka nga lojërat e tyre. Lojërat si lojëra, nuk dalloheshin gati aspak nga lojërat e Hënës tonë.
- Biçikleta me dy, tri apo katër rrota, kukulla me sy të larme apo të gjelbër, lule me shumë ngjyra apo lule të vetëm bardha të ndritura... njësoj, njësoj si tek ne.
- Shoh nga dritarja jashtë e cila kishte formën e gurabisë që mami në mëngjes herë pas here na i servon me Besën, e vërej se të gjithë njerëzit e Hënës ishin me

mjekra të bardha të buta, por si babi im, asnjëri nuk ishte...
- Blertii! Ç'ke Niki! Do dalim pak të fluturojmë – kërcejmë: (hi-hi-hi), jo edhe unë s'do vij me ju, dhe me kalamajtë e mi – u përgjigj zonja e Hënës.
- Urraa! Do të ecim mbi akullin e ngrohtë të malit të qelqit i cili i tërë i përbërë nga sheqeri.
- Do i shohim edhe qengjat me pupla të verdha që kullosin në barin e shtruar me çokollata të kuqe. Shumë bukur, ia priti Niku, e Blerti i kapi për dore kalamajtë e zonjës të Hënës dhe filluan shëtitjen në stilin fluturim – kërcim.
- Niku, zgurdulloi sytë e tij, në turmën e njerëzve të vegjël – xhuxha mjekërbardhë që ndoshta mos e heton babin e vet, që ka ardhur në Hënë, por si duket kot e ka.
Njeri të tillë nuk kishte.
Kështu shkuar, fluturuan – kërcyen, panë shijuan gjithçka, u gëzuan, kënaqen, dëfryen dhe në kthim për në shtëpi diku në një lumë të vogël ku uji lëvizte në formë të mjegullës së bardhë e të pastër në një ulëse për rreth asaj përroske, pa një njeri shtathedhur me shpinë të gjerë dhe të gjatë. Flokët i kishte të zeza dhe kokën jo shumë të madhe. Niku pa një pa dy aq shumë kërceu sa që me një hap u gjend pas atij njeriu dhe me tërë zërin që kishte thërriti. Babiii! Njeriu në ulëse ngadalë e

ktheu kokën, e Niku mbeti i shtangur me fytyrë fëmijërore të zbehur me dy pika loti në sy që shpejt i rrodhën faqeve të ngrira, buza iu dridh.
E kuptoi se njeriu nuk ishte babai i tij me atë buzëqeshje të ngrohtë dhe vetulla të holla.
Ishte një baba tjetër që ishte ulur e shikonte çunin e tij diku larg. Larg atje, ku xhaxhi i Hënës thoshte se atje i kemi shtëpitë tona të vërteta.
Blerti mu afrua, zonja Hënë më ledhatoi e kalamajtë e saj më afruan ca lypëse të barit por me shije të shijshme.
- Së bashku u kthyem në shtëpinë e xhaxhit të Hënës, i dëshpëruar dhe i mërzitur.
Blertit ia kapa dorën, ia shtrëngova fortë, dhe ia bëra me dije se nga pak frikohesha.
Si çdo shok i mirë edhe ai më shtrëngoi duke mi ledhatuar flokët e mia të drejta, ngjyrë kafeje. I lodhur i rraskapitur u hodha në krevatin e butë që gjendej mu para këmbëve të mia i mbylla sytë ngadalë dhe ashtu qetë më duket se tani më isha në gjumë...
Niki, Niki, o Niki...
Një dritë e fortë mi verboi sytë e mi të lodhur, dhe si zakonisht njëherë njërin, e mandej tjetrin sy i hapa ngadalë dhe ç'të shoh! Blerti ishte afër meje i tëri i katandisur dhe i frikuar, vrapoi Besa që

me atë çantën e saj të madhe sapo kishte arritur nga shkolla.
Dëgjova ca britma. Ç'po ndodh kështu?
- Mami, Mamii!
- Ndal Ruuk pak, a më duket a po më bëjnë veshët, sikur e dëgjova Besën.
Ç'ka? Përse thërret? Ajo qenka. Të dalim Haam!
- Ju djallusha të vegjël qenkeni.
- Nikun tim e pashë të shtrirë në një gurë të vogël afër portës së oborrit, i tëri i molisur.
Më lëshuan këmbët. U bë një rrëmujë e madhe.
Të gjithë i kapi frika: tetën Ruuk, mamin, Besën, Blertin, Blertin? E Blerti, pse është i frikësuar kështu më shumë se unë?
Shëndosh e mirë arritëm, dhe prapë jemi së bashku në këtë mëhallë të vjetër, afër kësaj porte të këtij oborrit. Si erdhëm, dhe kur erdhëm ende nuk më është e qartë.
Ku mbeti Hëna? S'ka gajle, me rëndësi është se prapë jam tek mami im, tek Besa, motra ime, ja ku qenka edhe Blerti, a?
Buzët më ishin tharë sa që nuk më ishin ngjitur.
Më kapi teta Ruuk dhe më vendosi nën hije më freskoi me ujë në sy, mi flladiti faqet e përvëluara dhe pa një pa dy kërceva në këmbë, si një edh i egër.
Mendova të fluturoj pak por disi për tu habitur – s'mundesha.

E kapa Blertin për dore, dhe i them të fluturojmë – kërcejmë pak sikur në Hënë. Më shikoi i hutuar, e mami prapë filloi të qajë. Diçka nuk ishte në rregull. Asgjë s'kuptova.
- Hyra tek dhoma ime dhe e Besës, e rashë të pushoj pak. Më kishte zënë gjumi. Më dukej si ëndërr, por mendja gjithë më rrinte tek babi.
- Si nuk pata fat që ta shoh. Ku ishte ai kur unë më së shumti kisha nevoja për të.
- Në mbrëmje, dëgjova, zëra, a është mirë? Ka fjetur? A mos ka temperaturë? Aty ishte xha Meri me tetën Ruuk, mami dhe Besa e Blerti si i shtangur në fund të dhomës vetëm vështronte.
- Më shikonin të hutuar, ngadalë e ngrita dhe iu afrova Blertit.
- Po, si je more Blerti? A nuk u trembe fare nga gjithë ajo rrëmujë në Hënë?
- Në Hënë? Po ç'ka flet ti Niki?!
- Unë ç'ka flas! Si çka flas! Po, a ishim së bashku në Hënë. Unë dhe ti.
- Mos u bëj foshnje. Ti ashtu mezi flet rrjedhshëm, e mua më thua, a ishim në Hënë.
- Hëm. Po, Blerti, ne a biseduam tek porta e oborrit për gjetjen e mënyrës së udhëtimit për në Hënë?
- Po, - Niki, e vërtetë, është kjo tash që thua.

Ne biseduam, se me ç'ka njerëzit udhëtojnë në Hënë. Ne u tallëm mes vete por, sidomos kur më the se me ato katrorët e tu dhe shkallët e drurit që i paske pas shtëpisë, do t'i vëmë, në maje të kodrinës mbi Arak dhe ashtu do të ngjitemi lartë, ndoshta deri në Hënë.
- Po de, Blerti ashtu ishte por a, s'të kujtohet kur në të dy i mbyllëm sytë dhe papritmas befasi, diçka filloi të bubullon, të dridhet?
- Jo, be Niki, s'më kujtohet një gjë e tillë?
- Po, si s'të kujtohet more gomarë!
Mos u tall me mua, çun i vogël.
Por edhe ti Blerti më the se dëgjon një të dridhur të tokës.
- Të ka bërë mendja. Unë nuk di asgjë.
E di vetëm, se ti Niki, mua më trishtove më shtyre frikën deri në këto kockat e mia, kur papritur rave si lule e këputur nga milingonat dhe përshpërisje diçka në vete.
- Eh, si more Blerti ashtu?
Unë e paskam ëndërruar gjithë këtë kohë?
- Haam, si qenka?
- Është me Blertin në ballkon.
I kam thënë me mijëra herë, që në Diell mos të eksponohet. I, ka rënë Dielli në kokë.
- Jo, moj Haamë, veç se Diellit ka edhe diçka tjetër. Po, e vërtetë Ruuk, ka edhe diçka tjetër. Është mërzitur për babin e

vet. Po, unë? Besa? A nuk jemi të mërzitura për Rinin?
- Ju ndoshta edhe më shumë, por meshkujt mërzinë e manifestojnë në forma tjera nga ne femrat.
- Asgjë! I kalon. I duhet një freskim dhe pushim i vogël dhe asgjë nuk qenka serioze. Jo ku qenka me Blertin tim, le të vazhdojnë të luajnë në park, nën hije – por jo në Diell, a?
- Eh, Blerti i dashur. Ti nuk e din se ç'më ndodhi mua. Çudi e mrekullueshme. Në të vërtetë si në ëndërr, por shumë reale. Po, a? Po të them.
Eh, e ç'farë limonada të larme kishte atje Niki? Po, bile edhe sheqerka të barit... paa, a mos kishte edhe bicikleta me pesë rrota, a? (hi-hi-hi). Po, Blerti, edhe me pesë rrota kishte Hmm (Blerti).
- Ti na frikove të gjithëve, sidomos kur më le vetëm e ty të zuri gjumi. Përshpërisje diçka në vete e në një moment dridheshe nga pak duke thirrur: babi, babi. Të pikuan dy pika loti në ato faqe të njoma të stërkuqura nga Dielli që pa zënë te buzët e tua të holla, u thanë e u zhdukën.
Ç'u bë? U trondita shumë.
- Po, si të them de Blerti, e din kur u qortuan dje, ti më shtyre a unë rashë, kur u fjalosëm për Diellin e Hënën? Po, po e?
- Të thashë se Diellin e dua sepse a nuk e lë babin tim që të largohet nga unë! Ti më

the se Hëna qenka e mirë. Po de! e mandej?
- Blerti, mua kur më the se Hëna është më e mirë se Dielli, sikur që më the se babi yt është i keq, dhe kurrë nuk ka për t'u kthyer tek unë. U zemërova aq shumë, sa që tërë natën nuk kam bërë gjumë.
- Mbyllja – hapja sytë, mbyllja – hapja sytë është gati tërë nata më kaloi. Bile shkoja shikoja tek dhoma e mamit dhe babit ashtu fshehurazi, prekja shtratin e tij, por kur shihja se është i ftohtë më mbusheshin sytë me lot dhe kthehesha i mërzitur në dhomën më të vockël.
- Në mëngjes kur rrezet e Diellit mi kishin kapluar qepallat mendova, se më mirë është që njëherë të shkoj, të ngjitem atje lartë në Hënë, dhe mos ndoshta rastësisht e takoj, duke më shikuar prej lart dhe duke ma bërë me dorë.
- Por, paska qenë një ëndërr aq e mirë e këndshme, por aq vrazhdët dhe mallëngjyese.
- Ah, more Niku i dashur, e tani të kuptova plotësisht.
- E di që je i mërzitur për babin tënd, për xha Rinin. Po më bie ndërmend, sepse nuk i mbathë patikat e reja që ti kishte blerë mami yt, por atë të vjetrat, që atë ditë ju shkuat në qytet, xha Rini, ti, Besa dhe zonja Haam.

Po, po mu ato patika mi tregove, që ti kishte blerë xha Rini. Të paskam lënduar dhe zemëruar shumë. Më fal të lutem. Edhe unë Niki, atë maicën që ma bleu dje babi kurrë nuk do ta shkyej. Çdoherë do ta ruaj dhe do të mburrem me te.
- Ti patikat e unë fanellën. A bën?
- Bën Blerti! Të kam thënë se ti je shoku më i miri i imi…
- Ndoshta duhet ta dërgojmë në mjek, a zonja Haam? Ç'thua ti? Të faleminderit zotëri Meri, por do e shohim. Ja këtu me zonjën Ruuk do pushojmë pak e mandej shohim se si do të jetë Niku.
- Mos u brengos Haam, se asgjë nuk ka.
Pak më tepër ka qëndruar në Diell, bile ti edhe më pate thënë se Niku, po e deshka shumë Diellin, e mu ato rreze e kanë molisur pak. Ç'i duhet një vogëlushi 5 vjeçar më shumë.
- Po shkoj se kam ca obligime e Ruka të rrinë pak më tepër tek ti, nëse duhet diçka vetëm më thërritni.
Mirë, Meri, shihemi pak më vonë në shtëpi. Në rregull Ruuk. Faleminderit zotëri Meri. Do të rrimë edhe ca me Ruukën tek unë.
Ditën e mirë. Mirëmbetshi.
- Ashtu e ka jeta Haam, mërziat dhe brengat janë për njerëzit, dikush më të mëdha dikush më të vogla. Niku yt qenka mërzitur.

Të thërrasësh Rinin, dhe të vjen. Edhe për ty do të jetë më mirë, e sidomos për Nikun dhe Besën.
- S'ka se ç'ka pret deri në pranverë. Më sa më kujtohet ai çdoherë ka ardhur në fund të pranverës – fillim të verës, e me Dimër shkon apo jo?
Ashtu është Ruuk, 8-9 muaj kurbet e 2-3 muaj sa dy-tre ditë në shtëpi. Por ç'të bëj...

Bora

Bora e parë herë e zë këtu, e herë-herë Rini vjen edhe para se të bie.
- Kurbet oj Ruuk. O afër, o larg, në shtëpi nuk e kam. Të gjithë e ndjejmë mungesën e tij.
- E vërtetë moj Haam, por a s'më the dje diç, sikurse Niku yt, të paska pyetur diçka për Diellin e Hënën, e ti qenke përgjigjur se e deshka Diellin, po që edhe Niku e deshka Diellin se ai po e shkrika borën! E?
Oh, moj Ruuk! Nëse nuk ka borë, Rini, babai i Nikut po qëndroja në shtëpi. Ashtu ka menduar ky çun i im i vogël, dhe bile kur më bie ndërmend se vende vende nuk e paskam kuptuar se ç'do të më thotë edhe më shumë shqetësohem.
- Paska qëndruar në Diell duke tentuar që të më thotë se asnjëherë nuk do të bie borë.
- Po, ku ta dish be Ruuk, se ç'ka ka menduar, por vërtetë u shqetësova sot kur e pashë ashtu të molisur dhe të mërzitur.
- Të gjithë fëmijët e duan borën, se ajo u sjell lojë, gëzime, dëfrime, shëndet e Niku im i tërë. Këto që i thashë i ndërron vetëm me qëndrimin e Rinit në shtëpi.

- Ku ta di, a? Asgjë në momente s'po kuptoj.
- Sa mirë është që të gjitha të mirat ti kemi në një vend, a Blerti? Po të gjitha. Diellin, Hënën, borën, xha Merin, babin tim, mamin tim, mamin tënd. Besën të gjitha, të gjitha, ashtu të jemi, vetëm së bashku.
- Eh, sa bukur do të kishte qenë ajo që thua ti.
- Në qiell në njërën anë – Dielli, me ato rrezet e tija të arta, e në njërën anë, Hënën rrumbullake ku do ti kishin përshëndetur xhuxhët dhe xhaxhin Lunar. Nën hije të pishës madhe tek unë, do të ishte ulur babi im, mami im, Besa unë por edhe xha Meri, zonja Ruuk, dhe ti.
Do të ishim veshur me rroba të trasha, sepse bora, është e ftohtë, e s'do të kishim ngrirë, a? (hi-hi-hi). Pse do të kishim ngrirë kur vetë the se Dielli do të na rrëzon me ato rreze e tija të arta e të ngrohta.
Ashtu, Blerti është, tok me ne do të ishte edhe ajo bora e bardhë, e butë dhe e ftohtë. E, di si të mpihet hunda nga ajo?
- E, di. Vjet kur e përcollëm xha Rinin atje larg, e përqafove, të puthi në ballë, ti ledhatoi pak flokët, Besës ia përkëdheli faqet e ftohura nga dimri, e zonjën Haam e puthi në buzë. Të kujtohet ty Niki?
- Ishte ditë me Diell, edhe Hëna ishte pak e zbehtë por e plotë – rrumbullake, bora

ishte mbi gjunjët tanë të hollë. Po, ashtu ishte, më dukej si, në ëndërr.
Hej, Niki, Nikii...! Ku je?
- Ja, ku jam Besa, Kush më thërret? Mami? Jo, nuk të thërret mami, por të thërret babi. Babi, të thërret, a kuptove? Blerti ku është? Ku është Hëna?! Të shoh dot e sheh ti? Ma bën me dorë? Më thirr? Ku Blerti bën me dorë? Më thirr? Ku Blerti, ku është?
- Jo, Niki, si duket babi yt të thërret në telefon. Po, a? Babii, babiii...
Ngadalë o marroq i vogël se do të bisedosh me babin! Alo babi! Unë jam. Jam bërë i madh. E dua Diellin. Të kam kërkuar edhe në Hënë.
I dua të gjitha, bile edhe borën. Babi, ty të dua më së shumti në botë.
-E di, biri im-trim. Ty të kam shpirt, zemër. Ti je më i çmuari se vetvetja. Edhe unë të dua ty. Por, babi pse ti nuk erdhe tek ujëvara me ujë të kaltër në Hënë. Të kam pritur! Po, si? S'po të kuptoj. Babi! Vetëm për ty kam qenë në Hënë. Babi, për ty shkoj edhe te Dielli. Po, përse çuni im ti të shkosh tek Dielli? Të ta përkëdheli atë veshin tënd të fortë.
Ti lëmoj ato vetulla të holla e të zeza. Të më përqafosh, e të më ngritësh lart deri tek ajo strofull e guguçes në pishën e madhe. E mban mend? Po, or çun im ashtu është, edhe unë për ty mendoj, zemra më këputet

që s'të shohë e s'të preki. Ju ëndërroj çdo natë, ty, Besën, mamin.
Ju ëndërroj sikur që më prisni tek porta e oborrit nën hijen e pishës së madhe, të cilën para shumë vitesh, e pata mbjellë unë, që juve tu bënë hije, e të ju freskojë.
Po, a? Urraa! Tani e dua edhe pishën e madhe. Tash do t'i tregoj Blertit se kjo qenka pisha e babit tim i cili e ka mbjellur për mua dhe Besën. Ashtu është. Por, Niki, pasi bisedova me mamin, e Besën, por tani edhe me ty, të tregoj diç? Do? Dua, babi, por vetëm mos më thuaj se ti vjen kur të shkrihet bora?
O, jo, joo, çuni im.
Unë do të vij Niki, para se të bie bora.
- Para se të bie bora thua? Urraaa. Mjaft Niki, mos qaj, tani unë do të flasë me babin pak. Ty të pret Blerti.
Mirë mami. Të përshëndes e të pres babi im i dashur. Urraaa...
Blerti, Blerti!
Si është koha? Me Diell apo me mjegulla? Ndal, Niki, ç'ke? S'ka lidhje, asgjë s'kam. Babi im, vjen tek unë para se të bie bora. Po a? Oh, sa bukur! Sa lajm i mirë Blerti! Fol, Niki! Por edhe sa ditë duhet të kalojnë deri sa të bie borë? Leri më tani këto biseda. Ende jemi në fund të verës, gati sa s'ka filluar vjeshta. E ç'ka ka në vjeshtë Blerti? Ç'bie në vjeshtë, a?

Në vjeshtë o Niko, pemëve u bien gjethet. Thua gjethet e pemëve bien në vjeshtë. Po, ashtu është. Po pse më pyet? Hmm, frikësohem se edhe pishës së madhe të babit tim po i pikon gjethet e s'do të mundemi që me babin të rrimë nën hijen e saj (hi-hi-hi).
Mos u friko Niki, se pishave nuk u bien gjethet. E sheh edhe vetë se ato nuk kanë gjethe. Kanë gjemba të butë si i injeksionet e tetës Nexhë! Të kujtohet kur të ka shpuar? (hi-hi-hi) Janë gjemba që asnjëherë nuk bien. Mirë qenka kështu Blerti, pra!
Por, pas vjeshtës, ç'ka bie?
E pas vjeshtës vjen Dimri plak dhe ai e bjenë dëborën – bie borë pra Niko.
Hej Blerti! – filluan që të bien gjethet, a?
Ja ku, ra një edhe një... Mos shpejto Niko! Ka kohë kur kjo rruga jonë mbulohet me gjethe të verdha si dukati të thata e të holla, e deri atëherë ne të lozim ndonjë lojë. Ç'thua ti? Luajmë Blerti. Ok: nisja...
- Besa ku je? Ja mami në dhomë. S'më tregove se si kalove në shkollë. Ç'ju dha mësuesi.
Tahë sot? Recituat vjersha, lexuat përralla? A u a përkujtoi matematikën me numra shumë që ti i ke shumë dëshirë t'i shohësh ëndërr? Po mami, bile na pyeti se si kemi kaluar në pushime verore, ç'kemi lexuar dhe ca ushtrime në matematikë i

bëmë. Aha. Po mirë moj çupëzë ime e vogël paskeni kaluar. Por në pyetjen se ku ishit për pushime verore, ti si u përgjigje? Hmm, mami më erdhi pak rëndë se shumë prej shoqeve të mia kishin qenë në det, në liqene, në fshatra, por të gjithë kishin qenë së bashku.
Me baba, mama, motra e vëllezër. Unë për herë të parë gënjeva e thashë se edhe unë kam kaluar pushimin veror në shtëpi, me babin me ty, me Nikun. Mu dridh buza kur e përmenda babin, sepse e gënjeva mësuesin Tahë.
Ti na ke mësuar që asnjëherë s'duhet të gënjejmë.
Më fal mami, por as unë nuk e di sepse veprova kështu. Thjesht s'munda ta paramendoj që në shtëpi gjatë tërë verës kemi qenë pa babanë. Të lutem më fal gabimin!
- Mirë, mirë, flutura ime; s'ke gabuar edhe aq shumë. Ti e di se të gjithë në e kemi babin në zemër. Edhe pse nuk është me ne, ai çdoherë është përreth nesh, dhe sikur të na shikon e dëgjon por për t'i ledhatuar ato flokë të mëndafshta ndoshta nuk mundet apo s'guxon.
Së shpejti do të na bashkëngjitet. E di? Dëgjove?
Po mami, prandaj edhe unë ashtu i thashë mësuesit Tahë, se edhe pse babi nuk është me ne, ai çdoherë është rreth nesh.

- Dua, që t'i hekurosi ca rroba të vjetra. Do të më ndihmosh pak? Po, si jo, moj mami im e dashur.
Ja, këto rroba të babit, ca të Unikut, të miat dhe ca të tuajat. Për shembull e mban mend këtë shall të hollë kur ta bleva në qytet!
Po, po, sa shumë u pata gëzuar, sepse shall të njëjtë kishte edhe shoqja ime Rinora.
Ajo ishte dhurata më e mirë për shkuarjen time të parë në shkollë.
Për uljen time të parë në ato banka të vogla shkollore. Por, mami e sheh edhe këtë fanellë me lule të kuqe, e me flutura të arta? Po e di, që edhe këtë ta kam blerë në të njëjtën shitore.
Ehee, jo mami, nuk është ashtu. Këtë e kam dhuratë prej babit kur e mora pesën e parë në fletore për shkronjën A të shtypit. Të kujtohet? Po, po, bija ime tani mu kujtua, ashtu ishte. Bile, mami mami, edhe atë kordhelkën ngjyrë pembe që e mbaj në atë çantën e vogël të lapsave ma ka blerë babi. Të kujtohet? Ahaa, po, po…
- Do të luajmë, do të luajmë – baba dimër.
Për mrekulli. Unë do të jem baba dimri, e ti Niki do të jesh një fëmi që i shkruan letër-porosi baba dimrit dhe shprehë dëshirë.

Niki, ti e din se nëse ndoshta e shkruan qartë e mirë, baba dimri mundet të ta realizon dëshirën. U bë Blerti.
Do të mundohem që ta shkruaj. Unë do të shkoj tani në shtëpi e të vishem si baba dimri, e të shkruajë dëshirën dhe ma lë letrën këtu. Tek porta e oborrit u bë? Mirë. Shkojmë tani (Trap-trap-trap)…
- Më tha Blerti të shkruaj një dëshirë. Por unë di vetëm ca shkronja bile edhe emrin tim mezi që e shkruaj. Për dëshirë nuk di. Oh, more Blerti ç'më bërëe? Besaa! Besaaa!
Ç'ke Niki! Ku je? Ja ku jam. Me mamin hekurosim ca rrobe të babit, të mamit, tuajat e të mijat. Por, përse më thërret kështu si i tërbuar?
- E din Besa! Me Blertin u morëm vesh që të luajmë fëmiun, me dëshira dhe baba dimri. Më tha që ta shkruaj një letër dëshirë, por unë krejt harrova t'i them Blertit se nuk di mirë të shkruaj. Ç'të bëj?
- Mos ke gajle vëllaçko, e ke motrën këtu. Kështu do të bëjmë.
Së pari, ti por edhe unë do të ndihmoj që ta shkruash dëshirën, domethënë unë do ta shkruaj atë që ti ma thua. E din?
Unë kam mësuar të shkruaj, edhe me të shtypit edhe me të shkrimit. U bë Besa.
Ja nisim.
- Ç'është diçka më e rëndë se kodrina e Arakut – fjala babi.

- Ç'është diçka më e ëmbël se sheqerkat me lara – fjala babi.
- Dielli, Hëna e Bora? Prapë është babi.
- Patikat e vjetra, fanella me lule e flutura – babi e mami.
- E, a është dita më e mirë se nata? Është, mirëpo babi e mami ua kalojnë edhe ditës edhe natës.
- Pesat e Besës, flokët e mia, nuk janë më të mira se vetullat e babit.
- As pisha e madhe nuk ia kalon bukurisë së mamit e babit.
- Nuk e di në botë se çka mundet të jetë më e dashur se babi e mami.
- Pra i dashur baba dimër:
Nuk dua Diell, as Hënë, as ditë e as natë, nuk dua patika maica e fanella, bile nuk dua as sheqerka, dua që nën hijen e pishës së madhe të më përqafon babi, të vrapojmë së bashku; unë, Besa e mami drejt në krahëror të babit, me veshët e fortë, e vetullat e holla e të zeza. Me duart e tij të buta, e me faqet e skuqura. Kjo është dëshira e parë dhe e fundit i dashur baba dimër, tjetër nuk kam, dhe asnjëherë nuk do të kem. Mirë, pra, Niki: nëse është kjo e tëra, e shkrujta dëshirën. Tani duhet dërguar tek vendi i porosive të baba dimrit. E di ku është? E di, Besa! Tek porta e oborrit. I ka unë Mami, erdha, me Nikun e shkruam një dëshirë. Ç'farë dëshire bija

ime? Ashtu thjesht një dëshirë e vogël e Nikut.
A e hekurose edhe atë fustanin me bleta? Po, ja tani jam duke e hekurosur…
- Ja ku qenka vendi tek, ky guri i madh. Këtu do ta lë dëshirën. Tani do të vjen baba dimri do ta merr, do ta lexon, dhe babi do të vijë në shtëpi. Erdhii! Po fshihem pak. Të shoh? (hi-hi-hi) Si qenka ky baba dimri – e paska një thes të vogël. Paska një mjekër të pambukut, dhe një kapelë të madhe (hi-hi-hi).
E di se do të më dëgjon. Po, patjetër do të më dëgjon. Do të ma shpie babin nën hijen e pishës së madhe.
- Nikiii! Fol, o baba dimër!
Po, mirë de Niko. Si s'dëshirove ndonjë veturë të vockël, ndonjë karamele apo ndonjë top të shfryer bile, por ti donë që ta sjellë babin tënd këtu.
- E ku e nxë ky thesi im babin tënd?
- Blerti, a më the, se baba dimri, fëmijëve ua plotëson gjitha dëshirat, nëse ato janë të shkruara mirë dhe nga zemra? Ti nuk je shok i mirë.
Do shkoj në shtëpi. Nuk luaj më me ty. Jam i hidhëruar. – Ika.
Po ndal more Niko, se babi yt këtu është. Të sheh, të ndjen, të dëgjon, vetëm se s'mundet të të përkëdhelë.
E di, por unë dua që ta përqafoj. Dua ta shoh, t'ia lëmoj ato vetulla të holla e të

zeza, e ato pak rrudha të shkurtra që i ka në ballë.
- Mirë pra, Niki! Ti, e din. Por mos u shqetëso shumë. Një ditë me të vërtetë do t'ia prekësh rrudhat në ballë. Të pushojmë, të flejmë, e të rritemi. Nesër prapë këtu tek porta e oborrit. A, bën? Hmm, Bën o Blerti. Kalofsh mirë tung.
- Aspak nuk e di se si e shkruam me Besën atë letër! Ajo mirë e shkroi, por nuk e di se pse baba dimri u hidhërua?!
Mami, Besa, ç'bëni?
- Ja, mbaruam me rrobat e hekurosura. Po të babit i keni hekurosur? Po, po edhe të babit i kemi hekurosur e paluar.
- Të përgatisim darkën e të hamë diçka o bylbyla të mamit.
Unë dua jogurt. Besa, t'i qumësht? Po mami ashtu është... (Njam, njam, njam).
- (Ding, dong, ding, dong) – ora 21.00
Niki eja cili më shpejt shkon tek dhoma, për t'i marrën pizhamet, dhe cili më parë do vishet. (Trass, Bumm, pljass) eee, t'i je më e madhe, e unë, jam aq sa jam, por, më i vogël se ti gjithsesi. T'i çdoherë më shpejt arrin tek dhoma.
- Gati? – Gati, mami! Natën e mirë, gjumin e ëmbël si përsheshi me tambël.
- Besaa (me y-ë të ulët)! – Ç'do natë mami na thotë: - gjumin e ëmbël si përsheshi me tambël. Sa ëmbël tingëllon kur e thotë këtë fjali. Niki të lutem më lerë të flejë tani.

Nesër më duhet të shkoj në shkollë. Duhet të jem e freskët e pushuar. Sa mirë që e kemi mamin me ne. Ka fëmijë në botë që as nëna nuk kanë. S'ka kush tu thotë: Natën e mirë e as gjumë të ëmbël, s'ka kush tu dëshiron ëndrra të mira fëmijërore.
- Ne vetëm babin nuk e kemi pranë, por a e dëgjove në telefon se ç'na tha, kur të bien gjethet e pemëve, do të jetë këtu.
- Nesër do të shkojë tek pisha e madhe, jo de te pish, por te bliri. Bliri ka gjethe. Do t'i mbledhë e grumbulloj në një çantë dhe do t'i ruaj. Të gjitha gjethet do t'ua mbledh pemëve, e kur të vij babi do t'i tregoj e do t'i them se për te i kam grumbulluar. Do t'i shtroj si dyshek nën pishën e madhe dhe do ta përqafoj. Do t'ia përkëdheli ato vetulla të gjata e të zeza. Edhe atë veshin e trashë do t'ia kapi.
- Po mami, gati jam. Kujdes rrugës Besa. Në shkollë të sillesh mirë. Ke marrë një mollë për ta ngrënë në pushimin e madh? Po mami, në çantë e kam. Ditën e mirë – ditën e mirë – Kujdes a?
- Shkoi Besa në shkollë?
- Uau, unë paskam fjetur më shumë se zakonisht. Ndaj, a mundem me majet e gishtave ta preki atë fundin e krevatit tim. Sa larg qenka. Më duket se qenkam rritur pak, por prapë qenkam i vogël. Më duhet të shkoj të ulësja e ftohtë e të urinoj. Kur

të rritem i madh do të shkoj te ulësja e madhe.
- Niki, u zgjove? Mirëmëngjesi mami! – po u zgjova, më zgjoi ai zëri i lartë i Besës kur shkoi në shkollë. Ka morën mollë, nuk ka marrën mollë. Mirë de, mirë.
- Laj sytë e pastroi dhëmbët. Të hashë edhe t'i një mollë të kuqe.
Ata fëmijë që hanë nga një mollë në ditë, janë të shëndoshë.
- Mami, më duhet një çantë e madhe mua!
Përse çuni im i vogël të duhet ty ajo çantë?
Po, ti ende je i vogël për në shkollë! Ka kohë.
Rritu ca edhe pak, e kur të del Besa në klasën e katërt ti bëhesh klasa e parë.
Mami, çanta më duhet për të luajtur me Blertin. Mirë, do e shohim ndoshta, atë çantën e vjetër të Besës me kollanë të këputur mos është dikund. Por, Niki! E, pe se sot Dielli nuk na shoqëron?
Ka mjegulla, bën pak më ftohët.
Do ta vishesh atë xhaketën me krahë të gjatë dhe këpucët e trasha.
Por pse mami këpucët e trasha?
Xhaketën e veshi me patikat e vjetra.
Si të duash. Por mos të rrish me Blertin tërë kohën jashtë. Mirë? U bë, mami. Ika te Blerti ta thërras.
- Blertii, Blertii! Mirëmëngjesi Niki! Mirëmëngjes? Mirdita duhet të thuash. Paskemi fjetur më shumë se zakonisht,

dhe se Dielli sot qenka fshehur mbi këto mjegulla të dendura.
Mendova se është mëngjes; apo jo?
Po. Ç'kemi sot ndërmend të luajmë o Niko?
Të luajmë të luajmë... Të mbledhim gjethe të pemëve. Ato gjethe që kanë ngjyrë të verdhë, e që janë shtrirë në tokë. Tani do e marrë edhe një çantë e i fusim në te. Mirë pra. Niki si të thuash. Jo nisim të mbledhim gjethet e ti fusim në çanta. – Mamiii?!
- Ma gjete çantën? Po. Eja merre, po të tash se bën pak më ftohtë sot. Mos të rrish g gjatë në rrugë. Nuk do rrimë në rrugë por do të jemi në oborr, në parkun e gjelbër dhe do të mbledhim gjethe. Shumë mirë pra.
- Blerti! Fol Niki! Jo çanta, dhe ia fillojmë. Ja fillojmë.
Ja ku qenka një gjeth, jo edhe një më duket se e pashë edhe një pak më larg.
Po, po, gjeth i zverdhur qenka. Ehehe 3 gjethe i kemi mbledhur. Niki! Urdhëro Blerti.
Po ç'ka je dalldisur me këto grumbullime të gjetheve de? Edhe pse e sheh se ende janë të gjelbërta dhe mezi që i gjetëm 2-3 në tokë. Po kudo i dërgosh më pas. Ç'ka do bëjmë me to. Oh, ç'farë shtrëngate e fortë e erës. Shih, shih, se si u mbush bari me fletëza të holla të verdha si pare – pare.

Gjethe gjethe, eh tani e mbushi çantën time plot e përplot. Niki! Nuk më the se përse i mbledhim ne këto?
- Blerti! A më the mua dje se pas verës, vjen vjeshta, koha ftohët, Dielli fshihet pas mjegullave e bien gjethet. Po, e? Dhe pas vjeshtës vjen dimri kur bien edhe flluskat e para të borës? Fjollat e borës janë ato. Po, po. Por, ç'ka donë ti të më thuash mua?
Ta thërrasim ne më shpejtë vjeshtën, ti ndihmojmë ne asaj. T'ia mbledhim gjethet. Po, a mirë de. Sikur të thuash ti Niki, edhe pse ne nuk mundemi ta thërrasim vjeshtën ashtu sikur ti thua. Ajo vetvetiu në kohë të caktuar ngadalë vjen, rrinë pak dhe ngadalë ikën. E, ku shkon Blerti? Po kështu Niki. Ajo shkon për ta kërkuar dimrin dhe borën.
Më duket Blerti se sot qenka vjeshta më e madhe. I sheh këto mjegulla? (hi-hi-hi).
Po Niki ashtu është, mirëpo ne ç'u bëjmë gjithë këtyre gjetheve tani? E mbushëm çantën përplot me to, dhe duhet t'i hedhim pas garazhës së xha Rinit. Jo. Nuk do t'i hedhim. Do ti ruaj. Do ti shtroj nën pishën e madhe.
Do të bëj një dyshek të butë, që kur të vjen babi, të shlodhët pak, se me siguri do të jetë i lodhur nga ajo rrugë e largët, e do të rrinë me mua në përqafim. Mirë Niko. Si të thuash.

- Ç'do ditë kështu do të veprojmë, e dyshekun do ta bëjmë të madh nga gjethet e mbledhura.
- Kaluan pra ditë. Kaluan javë, dhe në degët e pemëve mbetën vetëm ca fleta ashtu krenare por të zhveshura, që piknin një nga një në barin gjysmë të zverdhur, e që ne menjëherë i palonim në dyshekun e butë nën pishën e madhe.
- Pisha ishte e vetmja ngjyrë e gjelbër që mund të shihej për rreth.
- Një ditë me të vërtetë me Blertin u lodhëm, dhe ashtu të veshur me ato *vintijaknet* e trasha e shalle në fyt, na kishte zërë gjumi në atë dyshek më gjethe të buta.
Aty ishte ngrohtë dhe këndshëm.
U fundosëm deri në fund sa që mami shpeshherë dilte në dritare dhe nuk na shihte.
- Pas pak kohe, unë hapa sytë dhe pak si i hutuar shikoja.
Flluska bore. Gjithandej kishte floska bore. Po, po, fjolla të bardha bore sa grushtat tanë të vegjël.
Sytë mu mbushën me lot, më vinte të qajë me zë të lartë, por afër meje ishte Blerti i cili si dukej ende ishte në gjumë. Hej Blerti, o Blerti? Zgjohu! Ç'u bë Niki? Borë? Uau Borë! Bika Borë, borë bika! Të vrapojmë Niki, të luajmë të shkarravitemi në këtë borë të bardhë e të butë.

Nuk dua të luaj në borë. Nuk e dua borën. Do të rri këtu në këto gjethe, nën këtë pishë të madhe ku bora nuk depërton. Ashtu do të bëj. Mirë Niki, ti e din.
Unë po dal në rrugë të rrëshqasë.
Më duket se edhe ka fëmijë të mëhallës paskan dalë të dëfrehen.
Ik, unë do të rri këtu.
- E pse ti babi më gënjeve?
Më the se do të vish. Unë gjithçka kam bërë për ty.
Të kam ëndërruar, të kam përmendë, kam qarë për ty, jam hidhëruar me Blertin për tej. Kam buzëqeshur dhe jam gëzuar kur i mbledhja gjethet e këtij dysheku.
Vetëm për ty babi im i dashur. Po ti ku je?
Më harrove. A nuk e donë më atë Nikun e vogël, lazdran që rrokullisej mbi gjoksin tënd të madh, kur e luanim lojën me përbindëshin – gizilima?
- Do t'i mbylli sytë dhe do të pres këtu. Ashtu më pate thanë në telefon.
Më pate premtuar se para se do të bie bora e parë do të vishë në shtëpi.
- S'dua më të luaj me katrorë, e as me ato vetura të ftohta.
- Nikii, Nikiii? (me që të ulët)
- Zgjohu çuni im! Oh sa ëndërr e mirë. Më e mirë se ëndrra e Diellit, më e mirë edhe se ëndrra e Hënës, bile bile më e ëmbël se ëndrra e një fëmije kur e sheh se bie borë.
- Zgjohu, o çuni i babit!

Unë erdha. Këtu jam.
Babii!
- Vetullat e njëjta, veshët po ata që i ke pasë. Flokët e zeza?! Po, po, ashtu qenkan.
Të dua shumë, o babi im i dashur.
E dua mamin, Besën, por ty të dua më së shumti.
Këtë dyshek prej gjetheve e kam ndërtuar për ty. Të rrish me mua. Të më përqafosh.
Të shohim borën se si bie përreth nesh, e ne të dy, nën këtë pishën tënde të madhe, s'do të na prekë fare.
- Mirë de o çuni im. Mu ashtu si thua do të bëjmë Niki! Urdhëro babi.
Do të mbaj në duar dhe kurrë nuk do të lëshoj më. Edhe Besën do ta përqafoj, mamin do ta puthi në faqe. Në faqe?
Po çuni im, si të thuash ti, ashtu do të bëj unë.
- Babi, tani askënd nuk e urrej. E dua Blertin, e dua Diellin, e dua Hënën, borën, por shumë e dua mamin, e Besën, të gjithë tani unë i dua.
- Babi, të kam kërkuar në Hënë, të kam shikuar në Diell, e kam pritur borën që të vish.
Jo që të shkosh kur ajo bie, por të jesh pranë meje, kur ajo bie dhe e zbardhon e zbukuron barin e gjysmëzverdhur.
E sheh, se vetëm pisha jote e madhe, nuk e ka ndryshuar ngjyrën.

Edhe kjo e ka ditën se ti do të vishë një ditë tek unë. Së bashku me pishën e madhe të kemi pritur.
- Mami, mamii! Besaa!
- Ç'ke more dordolec? A mos je ngrirë, a?
Babi! Rini.
- Po, bija ime, po e dashura ime. Këtu jam. Erdha. Me ju do të jem. Se bashku, jo kështu të përqafuar. Asnjëherë nuk do të ndahemi më.
Niki, më ka qortuar dhe doemos duhet më ta dëgjoj.
Do t'ju dëgjoj të gjithëve.
Si të thoni ju ashtu do të bëj.
Eja, i dashur në shtëpi. Eja ngrohu pak.
Të hamë e të pimë.
Të festojmë deri në agim.
Mami nesër unë nuk shkoj në shkollë.
Më ka ardhur babi. Mirë mirë, nuk do të shkosh, do t'i them mësuesit Tahë se je duke i paluar, hekurosur rrobat e babit.
- Unë mami, nesër nuk do të luaj me Blertin tek porta e oborrit. Mirë Niki, ashtu le të jetë.
- Të dua, të dua, ju dua ju dua shumë, ju duam pa masë, ne tani jemi bashkë, kurrë s'kemi për tu ndarë.
- Gëzimi ishte i papërshkruar.
Ëndërr e vërtetë. Ëndërr që në mëngjes tregohen prej fillimit e deri në mbarim. Kjo motra ime, Besa nuk gënjeu edhe aq shumë. Njëherë dhe e fundit herë.

- E vështronim ashtu pak të lodhur prej asaj rruge të gjatë që e ka kaluar për të ardhur tek ne.
Rrudhat në ballë m'u dukën kësaj here pak më të thella, bile një ishte më e gjatë.
- Babi, rri pak ashtu, mos lëviz?
- Pse, o çuni im i vogël? Një e ke më tepër. Kanë qenë dy më të gjata e një më e shkurtër e tani i ke tri të gjata, një më të thellë, dhe një më te shkurtër.
- Po ç'ka o çun ashtu? Po rrudhat në ballë o babi im i dashur.
Mirë. Vazhdo, ma prek ballin me ato duart e tua të buta e të vogla, por në të vërtetë të forta që asnjë çun tjetër në botë nuk i ka si të tuajat.
- Dhe, më trego babi, më trego, pse ti më harrove? Eh, more birë? Është përrallë e gjatë për t'u treguar...
Kam marrë një pesë. Mësuesi Tahë ma ka shkruar në dorë edhe atë me yll.
Më dukej si në klasë të parë.
E kisha harruar çantën, librat, fletoret, atë kordhelken, që t'i ma pate blerë.
Për çdo ditë e mbaja në një tjetër çantë me lapsat.
- Recituam vjersha e unë e kisha mësuar një vjershë – tema ishte babi e mami.
Pas asnjë gabim e recitova dhe e mora pesën.
Shkëlqyeshëm. Po hajt moj bija ime a mundesh të ma recitosh edhe mua?

Po si jo be babi. Unë për ty dhe mamin e kam shkruar e përmendësh mësuar.
- Dy lot të nxehtë në faqe të ftohura dy xixa shkëndije e shpresë që bien në duart e mia të njoma. Kush janë?
- Eh, janë dy pëllumba mbi çati, dy yje në errësirë e dy pika uji në shkretëtirë.
- Po, po, por kush kush janë, ç'ka janë?
- Babi mami, dy fjali sa të ëmbla e të buta, sa të ngrohta, oh sa u luta që të jemi së bashku në këtë shtëpi, e tëra e mbushur me gëzim e lumturi.
- Të lumtë moj bija ime. Po ti me këtë vjershë më habite. Më befasove moj bija ima dhe bija e mamit. E ku, moj e ke mësuar, dhe kush ta tregoi?
- Mami diçka pëshpëriste, por unë në dhomë, kur Niku luante me lodrat e tija me ato katrorët edhe ku ta di unë se edhe me çka tjetër jo, bëhesha se po bëj detyrat e shtëpisë, mora një laps dhe një fletore, e shkrova këtë vjershë.
Nga brendia e zemrës më vinin ato fjali.
Kur i shkrova, u mahnita pa masë, dhe njëherit habitesha se pse më vinin këto fjali kaq të mallëngjyera, sa që herë – herë mu mbusheshin edhe sytë me lot.
- Bukur shumë. Ti je bija ime më e dashur dhe nxënës më e dalluar në klasën e mësuesit. Tahë. Por kur e përmenda po të pyes, se si është ai mësuesi Tahë, moj bija ime e vogël? Eh babi im. Çdoherë bërtet.

Të duket se do ta nxjerr prej bankës së tij atë shkopin e hollë, atë thuprën e tij të lëmuar e të thatë pasi si i bardhë, gjë që në të vërtetë vetëm njëherë ia kemi parë sytë e kurrë nuk na del prej mendjes.
Është mësuesi më i mirë që ekziston. Na donë dhe na ndihmon kur hutohemi në të lexuarit. Na e mundëson që të arrijmë shpejtësi në lexim.
Ashtu pra, edhe unë kur kam qenë nxënës sikur ti, kam qenë i prirë për lexim recitim. Isha pionier i Titos…
Titos? Ç'ka është Tita? Mos është ndonjë kukull me flokë ari? (ha-ha-ha).
Titoja, bija ime ishte një plak që i donte shumë fëmijët, por i tmerrshëm për prindërit e fëmijëve. Eh, paska qenë pra edhe i mirë, edhe i keq.
Lëre tani më këtë, por Niko t'i ç'ke bërë?
- I ke ndihmuar motrës sate në rregullimin e dhomës?
Po babi, i kemi renditur të gjitha lojërat që t'i dhe mami na i patët blerë. Edhe atë muzikën që lëshon zëra të zogut, këndesit, kalit… (hi-hi-hi).
- Pse Besa po më përqeshën, po si e ka emrin ajo kutiza që këndon? Ashtu është muzika që këndon si këndesi, zogu, kali… Haam! Si të kam ty shpirt?
Më qenke lodhur pak. E di.
Të rrish e vetmuar, me kujdesje të përhershme ndaj fëmijëve dhe shtëpisë,

mundem të paramendoj se si është. Por më së miri ti e din. E ke përjetuar në atë lëkurën tënde të butë e të bardhë.
Ashtu rëndë ishte o Rini, mërzi.
Çdoherë në pritje të një lajmi të mirë apo të kobshëm. Fjalë e premtime sa të duash, koka më është bërë daulle, sa që në fund u mbështeta vetëm tek perëndia. Thash në vete, vendosa: Perëndia është e pagabueshme. Ç'ka vendos, ç'ka donë atë e bën.
Lutjet e mia ishin të drejtuara tek Zoti.
- Me Rukën disi kaloja në llomotitje të zbrazët, duke shikuar çdoherë orën se kur do të kalon edhe një ditë pa fund.
Kur do të mbaron ky ankth, që as unë e as ti nuk e patën merituar. Por ç'të bësh, bota është e çuditshme. E ka mundur e keqja të mirën. Bile, bile mendoja se në ç'farë bote jemi duke i rritur këta engjëj të pafajshëm si jemi duke i përgatitur për sfidat e jetës anarkike.
A thua, mos jemi duke bërë mëkat me këtë moralitet hyjnor e veti tej qytetëruese që mundohemi t'ua transferojmë fëmijëve tani në këtë kohë?
Po Haam! E di! Por, rrugët e jetës ndonjëherë nuk kanë shenja. Ecën, dhe nuk e din se ku shkon.
Ashtu ka qenë dhe ashtu do të jetë.
Por t'i lëmë në këto biseda pa kripë, e të shohim se si është situata në kuzhinë.

Aha, kam përgatitur një pite me patate që ty ti ka ëndja shumë, por si duket edhe fëmijëve tanë u pëlqen ky specialiteti im. (ha-ha-ha).
- Niko, Besa! Ku shkuat!
Ja ku jemi mami?
- Pastrojeni fytyrën, lajeni duart. Pas pak kohe do të drekojmë. Mirë, mami.
- Hëmm, nuk e paska humbur aspak atë shije. Ku ta dish, se edhe sa kohë që të kalon pritja me patate e jotja është vetëm e jotja ku do të shkoj në botë. Po, be Rini im. Bota! Hëmm? Aq afër e aq larg të kam pasur. Të kemi ndjerë por s'të kemi parë. Ndoshta të kemi parë si në ëndërr, por pa të prekur. E ç'është ajo?
Lere këtë bisedë Haam!
Babi, babi! Fol Niki i vogël.
Ti atje, larg ke ngrënë këso pite të shijshme? Po, kam ngrënë pite, por kaq të shijshme dhe të këndshme si të mamit – jo! Mirëpo, Niki edhe kah të shkoj, e ç'ka të ha këso pite që të shkrihen në fyt, askund nuk do të gjejë. Mami e përgatitëm me një magji që askush nuk e dinë.
Vetëm ajo dhe askush tjetër nuk e din se si e bën.
Mami! Fol, Besa. E mua do të ma tregosh magjinë e pitës tënde? (Ha-ha-ha).
Po si jo moj bija ime, por t'i njëherë do të më ndihmosh që të hekurosim rrobe, ta pastrosh dhomën tënde, të mësosh të

rritesh e të bëhesh si flutur me krahë të gjatë, e mandej ta tregoj magjinë! A bën?
Hëmm, po si të thuash ti be mami.
- Të nesërmit në atë mëngjesin e ftohtë dhe me atë borën e bardhë hapa njërin sy, por për tjetrin nuk kisha guxim që ta hapi.
Mendoja se ajo dje që kishte ndodhur, ishte vetëm edhe një ëndërr e bukur por e shkurtë, mu si ajo e Diellit, Hënës apo e kësaj bore të butë. Hunda mu xigëlua nga një aromë e rëndë që gati më e kisha harruar.
- Tym i dendur i duhanit.
- Mami paska ndezur një cigare dhe e paska helmuar tërë shtëpinë. Ashtu mendova fillimisht. Por mami nuk e ndez cigaren. Babi po, por mami asnjëherë. Ngadalë veç syrit tjetër që veç mu u zgurdullua, e hundës së ngacmuar tani më edhe veshët dëgjuan një kollitje të thellë dhe të gjatë si ajo e babit.
- Për një çast isha tek dera e dhomës. Zgjata kokën në kuzhinë, ç'të shoh?! Një dorë e fortë mbante mes dy gishtave një cigare. Babi!
Mirëmëngjesi o çuni i babit.
Mirëmëngjesi o, babi im i dashur.
E përqafova ashtu sa munda, sa që mu ndal fryma.
- Po, ti këtu je a? (ha-ha-ha) – Po këtu jam.
Po t'i ku deshe që të jem unë o çuni i vogël?

Jo, jo, dua që çdoherë të jesh mu këtu ku jetoni.
Tek unë.
- Tymi i cigares i ndihmoi syrit tim të mbushur me lot, por e fajësova krejtësisht tymin e cigare. Bile pak u kollita, sa që babi menjëherë e fiku atë cigare të keqe.
- Hej, o çun! Urdhëro babi? Pasi prej këtij tymi të keq duhani t'u mbushën sytë me lot dhe u kollite, e bile që edhe mua është duke më bërë dëm në shëndet ta jap fjalën se kurrë më nuk do ta ndezi, e kurrë më nuk do ta mbajë në xhep.
- Urraa! Paska për t'u ndalur edhe ty ajo kollitja e thellë e gjatë.
Ndoshta edhe ajo rrudhë në ballë që të kishte dalë paska për t'u zhdukur. Ndoshta o çuni i im i vogël ka për t'u zhdukur.
- Po ti be Niki, si po ia kalon?
Blerti si është? Mirë be babi po kaloj.
Atë e kam shokun më të mirin. Është i sjellshëm dhe më kupton.
Ndonjëherë grindemi, por nuk zgjatë shumë menjëherë pajtohemi dhe ia fillojmë lojës. Ai ka një maicë që ia ka blerë xha Meri dhe tërë ditën e mban me vete.
Por një ditë edhe unë i tregova ato patikat me lidhëza të gjata që mi pate blerë t'i para se të ikësh larg, ashtu ia tregoja e mburreja se ti mi ke blerë dhe për atë arsye vetëm këto i mbaja. (ha-ha-ha). Po t'i

Niko ende i mban ato patika bardh e zi me lidhëze të gjata që t'i pata dhuruar së bashku me atë fustanin e Besës me arinj të vegjël e lualshtrydhe të malit? Po babi, ende i kemi, e i ruajmë. Prej teje i kemi dhurata. E din.
Babi dëgjomë të lutem! Asgjë më nuk dua.
As patika, as këpucë, e as maica. Të dua vetëm ty. Dua që t'i të jesh gjithmonë me mua. Këtu! A bën? U bë, çuni im i vogël.
Ashtu si të thuash do bëj.
Po unë, njëherë të dhashë fjalën. Ti a nuk më beson mua?
Ika, tani pak te Blerti.
Do të luajmë një çik dhe prapë do të vij. Ti këtu të rrish. Të mos largohesh nga shtëpia. Jo ku e ke dushekun me gjethe të buta nën pishën tënde të madhe. Të vishesh trashë dhe të pushosh pak. Je i lodhur nga ajo largësi e pafund. A bën?
Po, çuni im. U bë.
- Blertii!
- Këtu jam. Hej, a vetëm luan?
Përse nuk më thirrje?
- Po Niki të ka ardhur babi e mendoja që të mos bezdisi.
- Paj, ndoshta me të drejtë e ke, por me babin u mora vesh.
Ai çdoherë do të jetë afër meje.
Më ka dhënë fjalën. Askund më nuk do të shkon. Luajmë pak dhe prapë e gjejë në kuzhinë. Prapë luajmë e prapë e shoh nën

pishën e tij të madhe. Prapë luaj kur të dua e prapë e takoj në oborr tek porta. Shumë bukur Niki!
- Kjo bora aq sa e ftohtë, e aq edhe e nxehtë.
- E sheh, se si njëherë kur e prekën të ngrijnë gishtat. Por kur i futën në xhepa, të duket se po të digjen.
- Të bëjmë një dordolec! Ç'ka thua t'i Blerti. Mirë pra. Do të grumbullojmë borën. Unë do t'ia bëj këmbët me atë fanellën e trashë e t'i gjoksin dhe duart e prapë unë në fund do t'ia rregulloj kokën. A bën, Blerti?
- U kuptuam Niki.
Oh, sa e ftohtë qenka. E bardhë dhe e butë. Shih Blerti sa top të madh kam bërë. Këto janë këmbët, gjunjët të mbuluar me atë fanellën e gjatë.
Por edhe t'i Niki më ndihmo pak që t'ia japim formën këtij dordoleci.
Na duhet edhe një top më i madh borë për gjoksin e duart. E më në fund t'i e bën edhe një top të rrumbullakët për kokën. Po, po, Blerti. Gati e kam.
Ta ngritim këtë kokë të dordolecit mbi gjoksin e tij të fryrë, dhe t'ia bëj sytë, veshët...
- Hundën do t'ia bëjmë me një karotë të hollë, e veshët të fortë. Do t'i bëj edhe vetulla të holla me baltë, por ashtu të holla e të zeza. Njësoj sikur koka e babin tim.

As e madhe e as e vogël.
- Ti Niko, atë luajmë menjëherë thua si babi im. Mos u brengos fare o shoku im.
Më the se të ka dhënë fjalën se xha Rini, me ty këtu çdoherë më do të jetë. Apo jo?
- Ashtu është por ky dordoleci ynë në të vërtetë filloi që të përngjanë si baba dimri.
Si ai baba dimri që e zëvendësova me atë thesin e vogël kur luanim.
Ky dordolec është Blerti! Blerti, Blerti! (hi-hi-hi).
Po Niku, si unë qenka. Bile ashtu i rritur sa unë. As i madh e as i vogël. E bëmë edhe një shok. Tani jemi tre shokë të pandarë (hi-hi-hi).
- Mua pak më bën të ftohët! Ty Blerti si të duket. Është pak ftohët por ashtu e ka dimri.
Borë të nxehtë nuk ka.
Të hymë pak brenda tek unë, e të ulemi tek babi im, ta lusim, të na tregon ndonjë përrallë. Ç'thua ti Blerti?
Bën more Niki pse jo.
- Mirdita xha Rini! Mirdita more Blerti. Po ti qenke bërë burrë. Të kam lërë të vogël, e ti më dukesh qenke bërë gati sa unë.
- Po ashtu disi xha Rini, mirëpo me Nikun ne jemi vetëm dy fëmijë të vegjël e që besa prej kur erdha ti tek Niku, jemi edhe fëmijët më të lumtur në botë.
- Babi, ti mundesh të na tregosh ndonjë përrallë, deri sa të ngrohemi pak, se me

atë dordolecin deri sa e bëmë shok, të tërit jemi ngrirë. Një përrallë babi të shkurtër, e të lehtë, por të këndshme për veshët tanë të vegjël.
Ti din mirë që t'i tregosh.
Mirë pra, kështu fillon përralla:
- Kishte qenë, njëherë një çun trashalluk, që shtëpinë e kishte në pyll, buzë liqenit me ujë të kaltër e rrethuar me lule shumëngjyrësh, e flutura e kuqe. Ai ishte disi pak më i rritur se ju, por ishte vetëm një fëmijë i rëndomtë i cili veçse liqenin, pyllin, lulet e fluturat, askënd tjetër nuk kishte rreth vetes.
- Çdo ditë ulej me një gurë të lëmuar dhe e vështronte liqenin me atë ujë të pastër të kristaltë e në largësi shihte se si peshqit me pika të arta kërcenin mbi sipërfaqe të atij uji të akullt.
Bisedonte me ta, qeshte e ngandonjëherë edhe i dridhej buza në vaj, por nuk e dinte se pse.
Ashtu ditët i kalonin, por netët ishin të mbushura plot tmerr dhe të errëta.
Asgjë në botë nuk donte më shumë se një shok sa për të lozur e për të qeshur në atë dhomë të kasolles së vogël druri që shtrihej buzë liqenit e ngjitur me vetë pyllin.
- Ajo kasolle më parë i kishte takuar vetëm pyllit, por njëherit kishte shërbyer për

strehim të fëmijëve që kishin humbur rrugën.
- Babi, çuni me siguri e paska humbur rrugën në pyll? Po Niki, ai çuni e kishte humbur në pyll, e pylli e kishte strehuar në kasollen e vetes.
- Dhe si ju tregova në dhomën e tij kishte një tavolinë prej dëllinje dhe dy ulëse prej ahu. – Po përse dy ulëse ahu, xha Rini kur ai çuni paska qenë vetëm aty.
Po Blerti i dashur; ju thashë se ai ëndërronte, që të ketë një shok që luante e të mos mërzitej. – Ahaa?!
- Kështu një ditë çuni i vogël pasi doli në pyll, që veç më e kishte mësuar rrugën deri tek lëndina me luleshtrydhe të vogla të kuqe të ëmbla, dhe kërpudha të bardha, dëgjoi të lehura të qenve, dhe shpejt e shpejt me vrap u kthye në kasolle, duke e mbyllë derën e vjetër me një gurë të madh.
- Të lehurit e qenve sa vinin e rriteshin, bëheshin të padurueshme. Nga një dritare e cila më shumë i ngjante një vrimë të vogël, që vetëm koka e çunit depërtonte në te, pa se afër buzë liqenit ishte një kalë i bardhë.
Asi kali të bukur dhe madhështorë nuk kishte parë kurrë. Ishte i ndritur me qime të vizëlluara. Rrinte qetë dhe pinte ujë të pastër nga liqeni i kristaltë. Por më e çuditshmja ishte ajo që çuni, hipur në kalë pa një vajzë shtathedhur me fustan të

gjatë e të bardhë, i stolisur me gurë të çmuar, që nga lëvizjet e gurit e rrezeve të diellit shkëlqimi çunit herë pas here ia verbonin sytë.
Ashtu duke qëndruar në maje të gishtave në atë dritaren e vogël, çuni rrëshqiti dhe u rrëzua në dysheme e shtruar me barë të thatë e të butë me erë të këndshme që e kishte mbledhur tek ajo lëndina e luleshtrydheve, që njëherit e kishte edhe shtrat për të fjetur.
- Nga ajo zhurmë e shurdhër që u shfaq kali i vajzës së panjohur ngriti kokën, dhe lëvizi veshët në drejtim të kasolles së drurit ku ndodhej çuni. Vajza pak u tremb, por zbriti nga kali dhe hetoi se aty ishte një kasolle e drurit. Ngadalë duke u afruar, çuni e vërejti se sa e bukur ishte ajo vajzë. E bukur bile edhe sa agimi i mëngjesit mbi liqe. Edhe më e bukur se nata e mbushur me yje.
Qentë kërcëllonin dhëmbët, por me urdhrin e vajzës sikur që u tretën për një çast. Kapi atë rrezen e asaj dere gjysmë të prishur, dhe me një të shtyrë e rrokullisi atë gurë aq lehtë, sa që për çunin ishte shumë i rëndë.
- Hyri brenda, ç'të sheh!
- U habit e tëra, pa një djalosh të vogël i cili dridhej nga frika.
E mbulonte kokën me ato duart e tija të gërvishtura nga degët e pyllit e nga

shkëputja e fijeve të holla të barit për shtatin e tij.
Vajza i pëshpëriti me një zë aq të devotshëm, të ëmbël e të butë sa që çuni disi pak u qetësua.
- Po kush je ti o kalamaj?
Ç'bën ti këtu? Ku i ke prindërit. Qe sa kohë je ti këtu? Shumë pyetje, e asnjë përgjigje nga çuni.
- Unë jam Sini. Ashtu më ka thirr babi e mami.
- Mos u frikëso Sini. Unë jam Jeta. Edhe unë e kam shtëpinë larg, por këtu në afërsi është babi im me disa shokë e miq të vet, që kemi dalë në shëtitje. Kemi dashur që sado pak ta shijojmë këtë ajër të freskët magjik në këtë pyll të dendur thjeshtë bukuri e përrallave.
- Po t'i, ku i ke prindërit?
Si ke arritur këtu, dhe sa kohë je t'i këtu? Unë, Jeta isha duke lozur me ca shokë, dhe kur papritmas rrëshqita në një shkëmb të vogël e rashë në një hendek të thellë afër një lumi të vockël, afër një përroske. Nuk di më asgjë.
- Jam zgjuar në errësirë, dhe kam pasur tepër frikë. Shokët kishin ikur. Ndoshta më kanë kërkuar pas s'më kanë gjetur dot. Në drejtim të asaj përroske që ngadal bëhej vërtet lum fillova që të eci, dhe në mëngjes i tëri i rraskapitur, pashë këto liqene dhe këtë kasolle. U gëzova njëherë shumë,

duke menduar se këtu po banojka dikush. U afrova dhe pas pak çastesh kuptova se aty s'ishte askush. U strehova unë në këtë kasolle.
- Kjo është bora e dytë që jam këtu.
Oh, Sini! E tëra u tmerrova.
Eja me mua. Do të hypim në kalë. Do të kalërojmë nëse duhet edhe në fund të botës, vetëm për t'i gjetur prindërit dhe shtëpinë tënde. Po, a?
Mirë, Jeta! Shkojmë.
Kali kishte hapa të lehtë dhe të sigurta, e të lehurit e qenve mbeteshin mbrapa nesh.
- Shpejt e takuam babin e Jetës, i cili kishte diku në afërsi me ca miq të tij.
Kur e panë Jetën e Sinin në kalë mbetën të shtangosur.
Kush është Jeta. Ky kalamaj i tronditur, pak sa edhe bile i egër dukeshka?
Babi, është përralla e gjatë, por shpejt ne t'i gjejmë prindërit e Sinit. U bë, bija ime, shkojmë.
Kaluan nëpër pyllin e dendur, u ngjitën në maje të një kodrine shkëmbore, u lëshuan edhe në një lëndinë të pafund, kaluan një urë druri mbi një përroske, e diku në largësi si në mjegull, Sinit iu duke se e pa një shtëpi të bardhë me një pishë të gjatë. Njësoj sikur shtëpia e tij para se të humbej. Menjëherë mendoi se mund që ajo shtëpi të jetë e tij.

- I tha jetës që të drejtohet andej dhe pas pak kohe para se të errësohej u afrua dhe pa një njeri i cili në oborrin e asaj shtëpie ishte ulur dhe i tëri ishte në mendime.
- Sini kur u afrua disa hapa nga njeriu i cili rrinte me shpinë i kthyer nga çuni, vetëm njëherë lehtë thirri.
Babi?!
- Njeriu lëshoi një ofshamje të thellë në vete, por nuk lëvizi dot.
- Edhe njëherë Sini tha: Babi?! dhe këtë herë pak u afrua duke i bërë disa hapa në atë barë të tharë e gjethe të zverdhura, njeriu shpejt e ktheu kokën dhe e pa Sinin.
- Sini! Sini im i vogël?
- Po ku të kam o bir!
- Lot gëzimi, pikëllimi, habie e mrekullie.
Vrapoi mamaja e Sinit, e cila ishte një grua e hollë e thatë nga mërzia ndaj Sinit, e cila u rrëzua në tokë, por shpejt u ngrit dhe e përqafoi çunin.
Jetës i rrihte zemra me shpejtësi, ishte e lumtur të gjithë ishin të lumtur, pisha e gjatë nga puhia e lehtë e erës së asaj mbrëmje, i zgjati degët e gjata përreth toke sikur donte që edhe ajo t'i përqafonte të gjithë që gjendeshin nën kupolën e saj.
- Përralla mbaroi me një gëzim të papërshkruar e të gjithë jetuan së bashku në lumturi. Eh, babi. Ç'farë përrallë magjike.

Me të vërtetë, xha Rini, t'i përrallat i tregon aq mirë sa që nëse prapë do të vij tek t'i që të na tregosh ndonjë tjetër.
U bë, Blerti. Pasi je shoku më i mirë i Nikut, çdoherë je i mirëseardhur në këtë shtëpi. Tani, unë do të s'lodhem pak, e ju mos u largoni më larg se porta e oborrit.
I kam thënë pishës time të madhe që të ju vështron e të kujdeset për ju. U bë?
- U bë babi im i dashur.
Eja Niki, do rrimë afër dordolecit tonë, dhe do ta stolisim me ca lule të thata, që ende na qëndrojnë në atë vazon e mamit mbi televizor.
- Rini të mbuloj? Mos ke ftohët?
Jo e dashura Haam.
Mirë jam. Atje ku isha, ishte edhe më ftohtë.
Vetëm zemra ime gufonte llavë të nxehtë. Më mbante të qëndroj si shkëmb e si lis plak i paluhatur. Malli për ty, e fëmijët tanë ma bënte shpirtin si lumë të qetë por vende vende të dalldisur. Ehh...
- S'ka fjali, e as mëngjes të tregohet ajo çmenduri. I vetmuar, me ushqim të ftohur, i përgatitur me asgjë me mendje në shtëpi, e me xhepa të shkyer. Ulur në skaj të një dhome gjysmë të rrënuar e të errët, shikon nga dritarja njerëzit se si ecin në rrugë. Një dritare që nuk mbyllej deri në fund, me rrjete të çeliktë. E ftohtë, e gishtat ngjiteshin për një çast, lëkura më binte.

Po be, Rini! Jetë e çoroditur.
Për dikë e mbushur mjaltë e nektar, për dikë zeher e vrer.
- E din, vetëm dashuria jonë, i mbulon të gjitha këto vuajtje.
Fëmijë si dukat, të zgjuar e të ëmbël.
Çmimi i lartë për të jetuar kështu.
Shko, eja, vaj, lot, sy të tharë, e zemër të nxirë. Kështu? – Jo, Haam!
Kështu më – Jo! Këtu, Po!
Me ty, me Besën me Nikun.
- Mendoja, atë ditë kur erdha, se ç'më rrëfeu diç Niku. Përmendte Diellin, pëshpëriste diç për Hënën, më në fund më tha se nuk e deshka borën, e që mandej s'di se si thashë s'më kujtohet, bora qenka edhe e bardhë edhe e ngrohtë.
- I vogël ky Niku im. Deshi diçka të më thotë, por si duket të gjitha u janë përzier në atë kokën e tij të vogël e të njomë.
- Po shih. Rini, edhe mua para ca kohësh më ka befasuar. Ashtu unë një ditë përgatisja ushqimin në kuzhinë, vjen Niku, pa një pa dy më pyet:
- Ti mami e don Diellin, apo Hënë?
Unë thash Diellin, dhe Hënën. Të nesërmen të njëjtën pyetje. Mami ti në e donë më shumë. Diellin apo Hënën?
Ç't'i them: I thashë se më shumë e dua Diellin. Kërceu nga gëzimi.
Ashtu pas disa dite vetvetiu më thotë se Dielli është më i mirë se ai e shkrin borën.

- S'ka borë, s'ka shkuarje të babit larg.
- Shih, shih, ky çuni i vogël qenka bërë profesor. (ha-ha-ha).
Po be, Rini! Më shpërtheu një vaj, që e mbaja në gjoks e sytë s'guxonin që të pikojnë lot. Mu mbushën aq shumë sa që nuk shihja më se ku është Niku.
E përqafova, dhe fshehurazi më rrodhën ata lotët e grumbulluara si det nëpër faqet e mia të zbehura.
- Kalonin ditë e Niku vjen e më pyet prapë. Ti mami e donë Hënën? Ehh, rashë në hall me këtë zog të vogël të artë.
Ç't'i them. E pyes unë atë. Po t'i Niki e donë? Më përgjigjet se edhe Hëna qenka mirë.
- Po përse moj Haamë tani edhe Hëna qenka e mirë për Nikun kur ai njëherë të paska thënë se Diellin e deshka më shumë. Rini, ti si duket herën e fundit para se të largohesh nga shtëpia për në atë kurbet të mallkuar i paske thënë se mos të mërzitet, sepse nganjëherë ti shkon deri në Hënë, e sheh Nikun prej lart, ai bën me dorë. Në përshëndetë të gjithëve dhe prapë kthehesh atje larg, që ai ende s'po kupton se ku është ajo larg.
- Eh ky maroç i vogël. I paska regjistruar të gjitha fjalët e mia, pikë për pike.
Por Haam, të të pyes edhe diçka.
Fol, Rini im i dashur. Ndoshta ky çuni ynë i vogël edhe nuk e ka shumë gabim. Dielli

na i ngrohë këto eshtra të ngrira, e lëkura të zbehta, Hëna na i ndriçon këto sy tani që na u janë thelluar dhe u përngjajnë vrimave të zeza e bora na i flladitë gjokset tanë të përvëluar, na e shuan vrullin e shpirtrave të gufuar e trazuar si llava e nxehtë.
- Ndoshta, Rini i dashur, ndoshta ashtu edhe është.
- Besa, Niki!
- Erdhëm, mami!
- Blerti tani duhet të shkoj. Shihemi nesër.
Po të ketë Diell do të jetë i egër, mirëpo do t'i na i ndriçon me ato rreze të tija të lehta, hundët tona të ngrira e të skuqura në këtë dëborë të bardhë e të butë.
- Po Niki, të nesërmen shihemi.
- Babi babi, do të vishë në dhomën tonë të vogël?
E sheh, Besa se si lexon, e unë të tregoj rrugët e shkallët që i kam ndërtuar nga këto katrorë të vegjël.
- Fillo Besa, të dëgjoj!
Sa bukur. Po t'i Niko ç'je këtu? Oh, sa rrugë të gjata. Pse kaq të gjata i ke bërë o bir?
Babi, këto janë rrugë që më shpien tek ti.
Bile edhe pak më të gjata doja që t'i bëja.
Ti ishe larg, shumë larg, sa që mendoja se kurrë nuk do të më mjaftojnë katrorë, që të arrijë tek ti.
- Eh fëmijë të mi të dashur.

Këto biseda më kanë përfunduar.
Ti bija ime të mos e ruash më atë kordhelkën e vjetër në ato çantë të vogël të lapsave.
Ti Niki, t'i hedhësh ato patika të vjetërsuara me ato lidhëze të gjata gjysmë të këputura. Do t'u blej shumë kordhelka të reja e patika të bukura.
Çdoherë do të më keni pranë. Këto rrugë o biri im do të jenë më rrugë gëzimi e dëfrimi, e jo rrugë pikëllimi e mallëngjimi. Do t'u mbaj në duart e mia të forta deri sa të kem forcë. Mamin do ta ledhatoj si uji peshkun, e era pishën tonë të madhe.
Këtu do të jem dhe askund tjetër.
- Dielli, Hëna e bora do të jenë miqtë tanë të përhershëm.
Kudo që të jemi ato do të jenë me ne. Kudo që të shkojmë ato do të na shoqërojnë.
Në parajsë e amshim kështu vendosa o kalamaj të mi.

(E përfunduar, me rastin e ditëlindjes,
së vajzës sime Arbesës, më 30 shtator 2005)